

# SIGURIA NË INTERNET

Rezultatet kryesore nga opinionet e  
fëmijëve





# SIGURIA NË INTERNET

## REZULTATET KRYESORE NGA OPINIONET E FËMIJËVE

Qendra për studime të avancuara FIT  
2012



"Ky projekt u financua përmes grantit të Ambasadës Amerikane në Prishtinë. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Autorit(ëve) dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Departamentit të Shtetit."

Qendra për studime të avancuara FIT (Qendra FIT) është një organizatë e pavarur joqeveritare e themeluar në vitin 2011. Stafi i saj është profesional dhe ka një listë të profesionistëve Kosovar nga fusha të ndryshme specifike. Puna për këtë projekt lidhur me Sigurinë e Fëmijëve në Internet është e inicuar nga Qendra FIT dhe është e mbështetur financiarisht me një grant nga Ambasada Amerikane në Kosovë. Qendra FIT është një organizatë joqeveritare që merret me tema sociale të cilat e preokupojnë shoqërinë Kosovare dhe ka për synim të ndërtoj një reputacion të lartë për standardin e punës së saj në hulumtimet kualitative dhe kuantitative.

### **Kontributorët në këtë projekt**

**Stafi profesional i Qendrës për studime të avancuara FIT**

## Përmbajtja

Hyrje .....	5
Falënderimet tona.....	7
Përmbledhje ekzekutive .....	8
Përdorimi i internetit nga fëmijët .....	10
Sa e përdorin fëmijët internetin.....	10
Ku qasen fëmijët më shumë në internet.....	13
Sa gjatë qëndrojnë fëmijët në internet .....	16
Aktivitetet e fëmijëve në internet.....	17
Çfarë bëjnë fëmijët në internet.....	18
Komunikimi në rrjetet sociale .....	20
Lojërat Online .....	21
Rreziku në internet.....	23
Përvojat e këqija të fëmijëve në internet.....	23
Përmbajtjet Seksuale.....	24
Dhuna përmes internetit.....	29
Format e sajberdhunës .....	30
Përballja me sajberdhunën .....	32
Takimi me njerëz të rinj.....	33
Me kënd takohen fëmijët!.....	36
Faktorët tjerë të rrezikut .....	38
Publikimi i të dhënave personale në internet nga fëmijët.....	38
Keqpërdorimi i të dhënave personale.....	39
Ngritja e vetëdijes përmes këtij projekti .....	41
Konkluzione dhe rekomandime .....	46
Çështje metodologjike .....	48

# Hyrje

Anketa lidhur me Sigurinë e Fëmijëve në Internet është mbajtur në periudhën Mars - Prill 2012 në katër shkolla fillore të Komunës së Prishtinës. Në këtë Raport jemi fokusuar në prezantimin e rezultatet kryesore të dala nga përgjigjet e fëmijëve të marra përmes Pyetësorit të përdorur në këtë anketim i cili është i dizajnuar nga Qendra për studime të avancuara FIT (Qendra FIT). Ky pyetësor është unik dhe është mbajtur në mënyrë profesionale në katër shkolla fillore të Prishtinës. Ky raport ofron informata lidhur me përvojën e fëmijëve kosovarë në internet. Më saktësisht, është bërë përpjekje t'iu jepen përgjigje pyetjeve se: sa shpesh qasen fëmijët në internet, nga cilat lokacione, përmes cilave pajisje elektronike, cilat janë ngjashmëritë dhe dallimet sipas moshës e gjinisë së fëmijëve, cili është perceptimi i tyre lidhur me rrezikun në internet dhe dëmet e mundshme, cilat janë disa nga aktivitetet kryesore të fëmijëve në internet, etj. Gjatë diskutimit të këtyre temave vazhdimisht janë bërë edhe krahasime me disa vende të Europës për të parë se sa jemi edhe ne si shoqëri të ngjashëm me këto vende dhe ku janë dallimet kryesore. Këto tema paraqesin strukturën e këtij raporti, mirëpo gjithmonë gjatë leximit të këtij raporti duhet pasur parasysh se rezultatet janë të bazuar vetëm në katër shkolla fillore të Prishtinës, e jo edhe nga i gjithë territori i Kosovës.

Ky hulumtim është pjesë e anketës së Qendrës FIT për ngritjen e vetëdijesimit të fëmijëve lidhur me sigurinë dhe rreziqet kur ata qasen në internet. Në kuadër të kësaj fushate janë zhvilluar këto aktivitete: Është bërë një anketim për të krijuar evidencë bazë lidhur me sjelljet e fëmijëve në internet, është krijuar një uebfaqe që ofron shumë informata për sigurinë në internet ([www.internetisigurte.org](http://www.internetisigurte.org)) dhe për komunikim me palët e interesuara, janë përgatitur dhe shpërndarë materiale edukative (një udhëzues për prindër, një udhëzues për fëmijë, një poster me këshilla për fëmijë, një poster lidhur me të drejtat e fëmijëve në internet, tri broshura edukative lidhur me rrjetet sociale, sajberdhunën dhe të mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në internet dhe është përgatitë edhe një fletushkë për facebook-un. Njëherit në shkollat fillore: Faik Konica, Ismail Qemali, Pjetër Bogdani dhe Mileniumi i Tretë janë mbajtur seminare me nxënësit e këtyre shkollave, me ç'rast janë shpërndarë këto materiale edukative. Materialet edukative, përfshirë edhe këtë publikim, mund ti gjeni edhe në formë elektronike në adresën: [www.internetisigurte.org](http://www.internetisigurte.org).

Për më shumë, një anketë e dytë me fëmijët e Prishtinës është mbajtur në Tetor-Nëntor 2012 me qëllim që të matet efekti i fushatës së bërë në periudhën Mars – Tetor 2012 e ndërmarrë nga Qendra FIT për ngritjen e vetëdijesimit dhe të njohurive të fëmijëve në shollat e Prishtinës. Rezultatet e nxjerra nga pyetësori i dytë janë të prezantuara si një kapitull i veçantë në këtë raport (kapitulli 8).

Projekti Siguria në Internet është ndër iniciativat e para në Kosovë për të diskutuar këtë fenomen, i ndërmarrë nga Qendra FIT me qëllim që të kontribohet në rritjen e vetëdijesimit tek fëmijët, prindërit, mësuesit dhe publiku i gjerë lidhur me rrezikun që fëmijët mund të hasin gjatë kohës sa ata janë *online*.

Ne mendojmë se është përgjegjësi e gjithë shoqërisë Kosovare që të gjejë mënyra për tu kujdesur dhe për të mbrojtur fëmijët tanë nga rreziqet e mundshme, të cilat mund të vijnë si pasojë e qasjes së tyre në internet. Fëmijët janë pasuria jonë më e vlefshme që kemi dhe përfaqësojnë të ardhmen e ndritshme të vendit tonë. Ata janë shpresat e një shoqërie të shëndoshë Kosovare. Prandaj, mbrojtja e tyre duhet të jetë prioritet kombëtar. Posaçërisht, rolin kyç dhe më aktiv duhet ta bartin prindërit, familjarët dhe edukatorët të cilët pas prindërve janë burimi më i besueshëm për fëmijët. Në këtë raport fjala prindër është përdorë mjaft shpesh dhe përfshinë gjithsecilin që ka një marrëdhënie të ngjashme si prindi me fëmijën.

Në kapitullin e parë të këtij raporti, jemi fokusuar të analizojmë përdorimin e internetit nga fëmijët. Këtu kemi bërë përpjekje që të analizojmë se sa fëmijët e përdorin internetin, ku e përdorin ata më shumë dhe si qëndrojnë statistikisht krahasuar me vendet e tjera të Europës. Kapitulli 2 vlerëson aktivitetet e fëmijëve në internet. Njëherit në këtë kapitull janë bërë disa krahasime në përdorim të internetit sipas moshës dhe gjinisë. Në kapitullin 3 janë të prezantuara disa nga gjetjet lidhur me rreziqet dhe dëmet kryesore që fëmijët hasin apo mund të hasin në internet. Pastaj, në Kapitullin 4 dhe 5 fokusi kryesor është në çështjet që kanë të bëjnë me seksualitetin, pornografinë dhe dhunën në internet. Në kapitujt 6 dhe 7 janë të ekzaminuara qëndrimet e fëmijëve rreth lojërave online dhe faktorëve të tjerë të rrezikut. Në kapitullin 8 është bërë evaluimi i projektit gjashtëmuor të Qendrës FIT, pasi që janë mbajtur seminarët, me qëllim që të shikojmë se sa ky projekt ka arritur të ngris vetëdijesimin tek fëmijët lidhur me rrezikun dhe sigurinë në internet. Dhe në fund, kapitulli 8 përmban disa nga konkluzionet dhe rekomandimet tona të dala nga analiza e rezultateve të nxjerra nga pyetësi i përgatitur nga Qendra FIT.

Ne shpresojmë se ky material do të shërbejë si një fillim i mbarë për të kuptuar kompleksitetin e të qenurit *online*, mundësitë e shumta që përdorimi i internetit ofron dhe, në anën tjetër edhe rreziqet që vijnë nga përdorimi i internetit.

## Falënderimet tona

Projekti “Siguria në Internet” nuk do të bëhej pa mbështetjen financiare nga donatorët. Ambasada Amerikane në Prishtinë ka mbështetur financiarisht këtë projekt dhe kështu ka mundësuar që kjo ide të bëhet realitet.

Një numër i akterëve tjerë kanë kontribuar në mbarëvajtjen e këtij projekti.

Ne i jemi shumë mirënjohës Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Prishtinës që na dha leje për të mbajtur pyetësonin në gjashtë shkollat e Prishtinës. Gjithashtu falënderojmë shumë për ndihmën e ofruar nga stafi i shkollave fillore Faik Konica, Ismail Qemali, Pjetër Budi dhe Mileniumi i Tretë.

Falënderime shkojnë edhe për Departamentin kundër Krimeve Kibernetike të Policisë së Kosovës, të cilët na kanë ofruar informata të vlefshme për aktivitetet e Policisë në këtë fushë dhe kanë ofruar bashkëpunim me Qendrën FIT.

Së fundi, duam të falënderojmë shumë fëmijët që dhanë kohën e tyre për të marrë pjesë në hulumtimin tonë. Ata janë gurëthemeli i këtij projekti. Ne shpresojmë se disa prej tyre do ta shikojnë këtë publikim dhe do të lexojnë rreth vetes së tyre lidhur me ngjarjen e një shoqërie moderne kosovare që ata e kanë treguar.

Nga Editorët



## Përmbledhje ekzekutive

Përmes këtij projekti ne kemi provuar që të mësojmë lidhur me përvojën e fëmijëve online për të informuar opinionin e gjërë kosovar dhe politik-bërësit lidhur me të gjeturat nga ky studim me qëllim që ata të ndërmarrin veprime të duhura për të mbrojtur fëmijët. Prindërit dhe vetë fëmijët duhet të jenë më shumë të vetëdijshëm lidhur me mundësitë dhe rreziqet që ofron interneti. Publikimi i materialeve nga ky projekt për sigurinë e fëmijëve në internet në webfaqen e krijuar për këtë qëllim nga Qendra FIT ([www.internetisigurte.org](http://www.internetisigurte.org)) shtjellon dhe adreson çështje mjaftë të rëndësishme dhe komplekse për sigurinë e fëmijëve në internet. Kjo është vetëm një përpjekje e vogël në nivel vendi për të ngritur vetëdijen dhe mbetet shumë për tu bërë në këtë drejtim. Në Kosovë ka nevojë të bëhen studime më të thella në këtë drejtim dhe ka nevojë të bëhen më shumë kërkime për të kuptuar më mirë këtë fenomen dhe për të dhënë propozime se si të tejkalohen problemet e identifikuara dhe të merren hapa konkret për vetëdijesim të shoqërisë përballë kësaj çështje.

Përdorimi i internetit nga fëmijët e Prishtinës, në bazë të të dhënave të grumbulluara nga pyetësori i Qendrës FIT, ka dalë të jetë mjaft i lartë. Madje krahasuar me disa vende të Bashkimit Europian fëmijët kosovarë e përdorin internetin shumë më shumë (shiko figurën 1). Hulumtues të ndryshëm kanë gjetur që shfrytëzimi i lartë i internetit është në korrelacion të drejtë edhe me rrezikun më të lartë nga qëndrimi online. Kjo për faktin se sa më shumë që fëmijët qëndrojnë në internet, gjasat e tyre janë më të mëdha që (1) të shpërndajnë informata personale, sjellje e cila është mjaftë me rrezik, (2) të ekspozohen ndaj dhunës në internet, (3) të vijnë në kontakt me persona të panjohur dhe (4) të hasin në përmbajtje të tjera të dëmshme siç janë për shembull viruset e ndryshme. Duke qëndruar gjatë online, fëmijët bëjnë *chat* me njëri tjetrin dhe me persona të panjohur, me të cilët për herë të parë njihen përmes internetit. Takimi fizik me këta persona është gjithashtu një dukuri mjaft e rrezikshme. Përveç këtyre që përmendëm, numër i madh i fëmijëve kanë qasje të pakufizueshëm në internet dhe kjo dukuri gjithashtu mundëson që ata të mbeten më të ekspozuar ndaj përmbajtjeve që mund të dëmtojnë shëndetin fizik dhe psikologjik të fëmijëve apo mund të kyçen edhe në aktivitete të jashtëligjshme.

Objektivat kryesore të projektit 'siguria në internet' kanë qenë që të bëhet identifikimi i rreziqeve dhe nxjerrja e konkluzioneve nga ky hulumtim, pastaj të diskutohet lidhur me fenomenet që kanë të bëjnë me teknologjinë dhe politikat për përdorimin sa më të sigurt të internetit nga fëmijët. Ky projekt do të ofrojë të dhëna të cilat në njëfarë mënyre mund të konsiderohen si evidencë nga fëmijët e Prishtinës lidhur me përdorimin e internetit. Njëherit ne do të provojmë të bëjmë një mori krahasimesh me vendet e tjera të Europës për të parë se cilat janë ngjashmëritë dhe dallimet me këto vende.

Shfrytëzimi i internetit për punë, edukim, komunikim e jetë shoqërore, për shumikënd është shumë i

rëndësishëm. Duke përdorë internetin fëmijët janë në gjendje të udhëtojnë nëpër botë pa pasur nevojë të dalin nga dhoma e tyre (p.sh. përmes Google earth), të vazhdojnë të mësojnë pas përfundimit të orëve të mësimit në shkollë, të komunikojnë me njëri tjetrin (p.sh. Instant Messenger) dhe të krijojnë produkte të ndryshme në internet të cilat mund të shikohen nga e gjithë bota (p.sh. Web faqe personale, blogs, fotografi etj). Mirëpo me qëllim të maksimizimit të mundësive dhe minimizimit të rrezikut, politikëbërësve iu nevojitet të bëjnë shumë punë në këtë drejtim. Interneti sot është pjesë e ambientit natyral të fëmijëve dhe shumica dërmuese e tyre kalojnë një kohë të konsiderueshme në internet. Ne duhet t'ju tregojmë fëmijëve pse siguria në internet është shumë e rëndësishme, pse interneti është i mrekullueshëm dhe cilat janë përgjegjësitë e prindërve në këtë kontekst dhe rreziqet që fëmijët mund të përjetojnë nga të qenurit online.

# Përdorimi i internetit nga fëmijët

Interneti është një burim i shkëlqyeshëm ku fëmijët mund të kalojnë kohën, mirëpo përdorimi i tepruar i tij është i dëmshëm dhe duhet të zëvendësohet me aktivitete sociale dhe fizike në natyrë, të cilat janë shumë të rëndësishme për shëndetin dhe zhvillimin social të fëmijëve. Gjithashtu, qëndrimi i tepruar në internet duke lënë anash detyrat e shtëpisë mund të jetë mjaftë i dëmshëm për suksesit e tyre në shkollë. Surfimi në ueb nuk duhet të zëvendësoj kohën e aktiviteteve të tjera të rëndësishme, përfshirë aktivitetet apo lojërat në natyrë, detyrat e shtëpisë. Akademia Amerikane e Pediatriisë rekomandon që të limitohet koha e qëndrimit të fëmijëve mbi moshën 2 vjeçare para ekranit televiziv apo kompjuterit në më pak se 1 ose 2 orë. Rritja e vetëdijes lidhur me shfrytëzimin e internetit bëhet më e vështirë në rastet kur prindërit nuk kanë njohuri bazike për përdorimin e internetit dhe teknologjisë së re kompjuterike. Në këtë raport ne kemi eksploruar shkallën e përdorimit të internetit nga fëmijët dhe rezultatet nga deklaratimet e fëmijëve janë të prezantuara në vijim.

## Sa e përdorin fëmijët internetin

Për të kuptuar nëse fëmijët e anketuar përdorin internetin dhe nëse prindërit e tyre e përdorin internetin gjithashtu, në pyetësorin Qendrës FIT kemi vendosur këto dy pyetje:

*“A e përdorni ju personalisht internetin?”;*

*“Po prindërit tuaj a e përdorin internetin?”.*

Rezultatet e shprehura në përqindje nga këto dy pyetje janë paraqitur në tabelën 1. nga ku vërehet se shumica e qytetarëve të Prishtinës e përdorin internetin. Jo për t'u befasar, ka rezultuar se përdorimi i internetit është më i lartë nga fëmijët krahasuar me prindërit e tyre.

**Tabela 1. Shfrytëzimi i internetit nga Fëmijët dhe Prindërit,**

Kategoria	në përqindje			
	Po	Jo	S'kam përgjigje/Nuk e di	Gjithsejt
A e përdorni ju personalisht internetin?	90	8	2	100
Po prindërit tuaj a e përdorin internetin?	82	17	1	100
Baza: 639				

Rreth 90% e fëmijëve janë deklaruar se shfrytëzojnë internetin, kurse 82% e tyre kanë deklaruar se internetin e përdorin edhe prindërit e tyre. Kjo përqindje e shfrytëzuesve të internetit ka rezultuar të jetë mjaft e lartë, ndoshta, edhe për faktin se në mostër janë të përfshirë vetëm fëmijët e Prishtinës. Zonat rurale të Kosovës të cilat mund të dallojnë nga Prishtina nuk janë përfshirë në këtë studim. Me


gjasë, edhe diferenca në përdorimin e internetit në mes të prindërve dhe fëmijëve në nivel të Kosovës mund të jetë ndryshe nga ajo e nxjerrë vetëm në qytetin e Prishtinës.

# 90%

e fëmijëve të Prishtinës kanë deklaruar se e përdorin internetin

Komisioni Europian ka bërë një studim lidhur me përdorimin e internetit nga fëmijët me fokus në sigurinë e tyre dhe rreziqet e mundshme, i cili është shumë më voluminoz me një shtrirje në 25 vende të Europës<sup>1</sup>. Bazuar në të gjeturat nga ky studim të publikuara në vitin 2011, ka dalë se mesatarisht 86% e fëmijëve të këtyre vendeve e përdorin internetin (Figura 1). Sipas këtij studimi, më së paku qasje në internet kanë fëmijët Grek (55 %) dhe ata Italianë (59 %). Më së shumti internetin e përdorin fëmijët nga Britania e Madhe, Suedia, Norvegjia dhe Finlanda (të gjitha nga 98 %). Në projektin e Komisionit Europian kanë qenë të përfshira këto shtete: Austria, Belgjika, Bullgaria, Qiproja, Republika Çeke, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Hungaria, Italia, Irlanda, Lituania, Holanda, Norvegjia, Polonia, Portugalia, Rumania, Sllovenia, Spanja, Suedia, Turqia dhe Mbretëria e Bashkuar.

**Figure 1. Përdorimi i internetit nga fëmijët sipas shteteve**



<sup>1</sup> Livingstone, S., Haddon, L., Görzig, A., and Ólafsson, K. (2011). Risks and safety on the internet: The perspective of European children. Full Findings. LSE, London: EU Kids Online.

Burimi: Full Findings. LSE, London: EU Kids Online, të dhënat për Kosovën janë nga Qendra FIT.

Në Kosovë, me gjasë po të përfshiheshin edhe qytetet e tjera të dhe zonat rurale, kjo përqindje do të ishte më e ulët. Sido që të jetë bazuar në rezultatet nga qyteti i Prishtinës, ne mund të konkludojmë se ka një penetrim mjaft të lartë të fëmijëve dhe prindërve kosovar në internet. Hulumtime të ndryshme potencojnë se shfrytëzimi i lartë i internetit është në ndërlidhshmëri me rrezikun më të lartë nga të qenit online. Rreziqet në internet mund të jenë të natyrave të ndryshme, siç janë sajberdhuna, takimi me njerëz të panjohur, shikimi i përmbajtjeve të papërshtatshme për fëmijë, dëmtimet e ndryshme në kompjuter etj. Sipas të dhënave të këtij hulumtimi ka dalë që në përgjithësi gjinia femërore ndjehet më e rrezikuar. Vajzat janë më shumë të ekspozuara ndaj rrezikut ndërsa djemtë janë gjithashtu mjaft të ekspozuar, sidomos ndaj fenomenit të dhunës ndërmjet vete. Ata janë në gjendje që të kërcënojnë me dhunë më shumë si gjininë femërore ashtu edhe njëri tjetrin.

Në vendet e tjera të zhvilluara i kushtohet shumë rëndësi ngritjes së vetëdijes për sigurinë dhe rrezikun gjatë përdorimit të internetit. Projekti i mësipërm i financuar nga Komisioni European tregon seriozitetin dhe kjo është vetëm një nga përpjekjet e këtyre shteteve për të rritur njohuritë e fëmijëve dhe prindërve të këtyre vendeve me qëllim që të informohet opinioni dhe të bëhet promovimi midis akterëve të ndryshëm qofshin kombëtarë apo ndërkombëtarë për një mjedis më të sigurt për fëmijët. Ne, në këtë raport, gjatë diskutimit të temave të ndryshme do të bëjmë krahasime të shpeshta me rezultatet e nxjerra nga ky hulumtim, i publikuar në vitin 2011.

Sipas të dhënave nga sondazhi i Qendrës FIT ka dalë që shkalla e përdorimit të internetit nga fëmijët e Prishtinës dallon varësisht nga mosha e fëmijëve dhe gjinia e tyre. Tabela 2 përmbledh rezultatet e përdorimit të internetit sipas moshës dhe gjinisë, të shprehur në përqindje<sup>2</sup>.

**Tabela2. Shfrytëzimi i internetit nga fëmijët**

Kategoria	në përqindje			
	PO	Jo	S'kam përgjigje	Gjithsejt
9-10 vjeç	81	18	1	100
11-12 vjeç	91	7	2	100
13-14 vjeç	92	4	4	100
15-16 vjeç	98	2	0	100
Meshkujt	91	7	2	100
Femrat	89	10	2	100
Gjithsejt	90	8	2	100

<sup>2</sup> Rezultatet nga pyetja: "A e përdorni ju personalisht internetin?"

Të dhënat tregojnë se përdorimi i internetit nga fëmijët rritet për secilin vit që fëmija bëhet më i moshuar. Mbi 90% të fëmijëve të moshës 11 vjeçare e përdorin internetin. Në përgjithësi ka dalë që djemtë e përdorimin internetit pak më shumë (rrethe 2%) krahasuar me vajzat.

### Ku qasen fëmijët më shumë në internet

Fëmijët e përdorin internetin në mënyra të ndryshme, nga pajisje elektronike të ndryshme dhe nga ambiente të ndryshme. Kjo ndryshon mjaft, varësisht nga moshja e tyre, interesat dhe rrethana të tjera të caktuara. Për të kuptuar këtë se nga ku qasen më shumë, në pyetësor fëmijët janë pyetur lidhur me vendin ku ata e përdorin internetin. Në pyetjen se ...

*“Nëse e përdorni ju internetin, në cilin nga këto vende e përdorni?”*

ata kanë dhënë këto përgjigje:

**Tabela 3. Ku e përdorin internetin fëmijët**

Kategoria	Në përqindje
Në shtëpi	97
Nga telefoni mobil	46
Në internet café	16
Në shkollë	11
Tjetër	12
Gjithsejt	90

Në mënyrë dominante vërehet se vendi më i preferuar i fëmijëve për tu qasur në internet është shtëpia. Rreth 97% e fëmijëve që janë deklaruar se kanë qasje në internet, janë përgjigjur se kycjen në internet e bëjnë nga shtëpia. Për të parë se sa ata e preferojnë privatësinë dhe nga cili ambient më saktësisht qasen në internet, si dhe për të konfirmuar edhe njëherë pyetjen e mësipërme, fëmijët janë pyetur nga mesi i pyetësorit edhe njëherë me një pyetje të ngjashme<sup>3</sup>:

*“Në cilin nga këto vende e përdorni internetin?”*

Përgjigjet nga kjo pyetje janë paraqitur në tabelën e mëposhtme dhe të dhënat tregojnë se fëmijët më së shumti e përdorin internetin nga dhoma e fjetjes (65%). Kjo tregon se fëmijët preferojnë të kenë lirinë e tyre, privatësinë dhe me gjasë nuk dëshirojnë që të monitorohen. Përdorimi nga dhoma e ndejës është për 5% më e ulët krahasuar me dhomën e fjetjes. Sipas shumë studiuesve kjo dukuri është mjaft shqetësuese dhe ata rekomandojnë që kompjuteri në shtëpi duhet të vendoset në dhomën e ndejës dhe pozicionimi i monitorit të bëhet në atë mënyrë që të gjithë të kenë mundësi të shohin monitorin gjatë përdorimit të internetit. Sidoqoftë, në familje ku përdoren më shumë se një pajisje që kanë mundësi për lidhje në internet, duhet pasur kujdes, sepse këmbëngulja e prindërve se

<sup>3</sup> Opcionet e mundshme të ofruara për zgjedhje janë paraqitur në tabelën 3.

të gjithë duhet të përdorin internetin në të njëjtën dhomë dhe në të njëjtën kohë mund të shkaktojë pakënaqësi. Rekomandohet që prindërit të jenë sa më shumë të pranishëm në momentet kur fëmijët janë duke përdorur internetin, ose të bëjnë përdorimin e programeve për monitorim siç është “parental control”<sup>4</sup>.

Sipas të dhënave të Qendrës FIT, në përgjithësi nuk vërehet se ka ndonjë dallim të madh në mes të djemve dhe vajzave në këtë aspekt, mirëpo vërehet një dallim sipas moshës.

**Tabela 4. Përdorimi i internetit sipas ambientit**

Kategoria	në përqindje		
	Po	Jo	Gjithsejt
Në shtëpi në dhomë të fjetjes	65	35	100
Në shtëpi në dhomë të ndejes	60	40	100
Në shkollë	8	92	100
Në internet kafe	15	85	100
Në shtëpi të shokut	30	70	100
Në shtëpi të një të afërmi	32	68	100
Dikund tjetër (psh. iPhone, iPad, etj.)	41	59	100

Jo për tu befasuar ka dalë që fëmijët e moshës *mbi 14 vjeç* preferojnë shumë më shumë të përdorin internetin në dhomë të fjetjes (70%), krahasuar me përdorimin në dhomën e ndejes (58%)<sup>5</sup>. Kjo tregon se sa më shumë që fëmijët rriten, ata kërkojnë më shumë privatësi gjatë përdorimit të internetit. Adoleshentët preferojnë shumë më shumë të përdorin internetin në privatësi në dhomën e tyre të fjetjes kundrejt ambienteve në të cilat gjenden anëtarët e tjerë të familjes ku supozohet se ata mund të vëzhgohen nga ndokush prezent.

**65%**

e fëmijëve të Prishtinës kanë deklaruar se e përdorin internetin në dhomën e fjetjes.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm është përdorimi i internetit përmes telefonave mobil. Përdorimi i teknologjisë mobile është një fenomen në rritje e sipër dhe për këtë aspekt nevojiten të merren


<sup>4</sup> Për më shumë këshilla rreth kësaj teme shiqo Udhëzuesin për Fëmijë të përgaditur dhe publikuar nga Qendra FIT në linkun [www.internetisigurte.org](http://www.internetisigurte.org).

<sup>5</sup> Me qëllim që të sa më shpejtë të njerrim një raport me rezultatet e para dhe që ky raport mos të dominohet me tabela e figura, disa nga rezultatet e nxjerrura vetëm do të komentohen dhe nuk do të paraqiten në formë tabelare apo figurative.

masa për të mbrojtur fëmijët. Figura 2 prezanton trendin në përqindje të fëmijëve sipas **moshës** dhe **gjinisë** të cilët e përdorin internetin përmes telefonave mobil.

Nga deklaratimet e fëmijëve ka dalë që në përgjithësi, rreth 43% e fëmijëve e përdorin internetin nga telefoni mobil. Djemtë dominojnë në përdorimin e internetit nga telefonat mobil (58%) kundrejt vajzave (42%). Gjithashtu vërehet se deri në moshën 14 vjeç ka një trend të njëjtë të rritjes së përdorimit të internetit për të dy gjinitë. Mirëpo moshë 15 vjeçare dallon me përqindje më të lartë për vajzat (72%), kundrejt një rënie të interesimit të djemve për qasje në internet nga telefonia mobile (vetëm 53%). Është interesant se përqindja e moshës 11 vjeç ka dalë të jetë më e lartë krahasuar me gjeneratën e fëmijëve 12 dhe 13 vjeç. Kjo vlen si për vajzat ashtu edhe për djemtë.

**Figura 2. Qasja e fëmijëve në internet përmes telefonit mobil sipas moshës dhe gjinisë**



Zhvillimi i shpejtë i teknologjisë informative ka ndikuar që të ndryshojnë edhe sjelljet e fëmijëve në ditët e sotme. Në Kosovë të gjithë operatorët që ofrojnë shërbime të telefonisë mobile tani ofrojnë edhe shërbime të internetit nëpërmjet telefonit mobil. Rrjetet sociale sot janë integruar në ‘telefona të mençur’ dhe përhapja e wireless-it gati ka bërë të pamundur monitorimin e qasjes së fëmijëve në internet. Prandaj rekomandohet që prindërit të rrisin komunikimin me fëmijët për përdorimin e internetit dhe të telefonit. Prindërit në pajtueshmëri me fëmijët duhet të krijojnë një listë të rregullave për përdorim të internetit dhe telefonit, e cila duhet të përmbajë rregullat se si dhe kur fëmijët mundën ta përdorin internetin dhe telefonin. Prindërit duhet të monitorojnë fëmijët e tyre se sa gjatë qëndrojnë në telefon, me kënd bisedojnë, të mos lejojnë që fëmijët të përdorin telefonin në orët e vona të natës dhe t’i udhëzojnë fëmijët që të mos aranzhojnë takime të drejtpërdrejta me persona që nuk i njohin mirë.

Më shumë udhëzime për këtë temë janë dhënë në “Udhëzues për Prindër” të zhvilluar nga Qendra FIT dhe i cili gjendet në [www.internetisigurte.org](http://www.internetisigurte.org).

Qasja në internet **në shkollat** fillore në Prishtinë ka dalë të jetë mjaft e ulët krahasuar me vendet e



Bashkimit European. Në vendet e BE-së qasja në internet në shkollë zënë vendin e dytë në përgjithësi. Në Prishtinë vetëm 11% e fëmijëve të anketuar kanë deklaruar se e përdorin internetin në shkollë. Mesatarja e përdorimit të internetit në shkolla fillore sipas anketës të mbajtur në 2010 me 25 vendet e Europës ka qenë rreth 63%. Shfrytëzimi i internetit në shkolla private në Kosovë ka dalë të jetë shumë më i lartë. Rreth 35% e fëmijëve të shkollës Mileniumi i Tretë janë deklaruar se e përdorin internetin në shkollë dhe kjo ka përmirësuar mesataren në nivel të të gjitha shkollave. Fëmijët e moshës 9 – 10 vjeç nuk janë deklaruar se kanë qasje në internet në këtë shkollë. Në shkollat shtetërore vetëm 5% e fëmijëve kanë deklaruar se kanë qasje në internet nga objektet shkollore.


Rreth 16% e fëmijëve 9 – 16 vjeç janë deklaruar se e përdorin internetin në lokalet e quajtura *internet-café* dhe shumica e tyre janë djem (82% djem kundrejt vetëm 8% vajza). Në vendet e Bashkimit European qasja e fëmijëve në *internet-café* në vitin 2010 ka qenë rreth 12%. Qasja më e lartë në *internet-café* në Kosovë krahasuar me vendet e BE-së mund të lidhet edhe me faktin se familjet Kosovare mund të kenë më pak kompjuterë krahasuar me familjet në këto vende. Frekuentimi i shpeshtë i internet-caféve nga fëmijët mund të jetë shqetësues meqë ato shpesh janë ambiente publike për nga natyra dhe shumë të pambrojtura ndaj sulmeve (p.sh. të hekerëve të ndryshëm për të marrë informata sensitive mirëpo shumë shpesh edhe ambiente jo mjaft të përshtatshme për të qëndruar kohë të gjatë).

Po ashtu rreth 12% e fëmijëve kanë deklaruar se internetin e përdorin *nga vende të tjera*, përveç këtyre që u përmendën më lartë.

## Sa gjatë qëndrojnë fëmijët në internet

Në bazë të të dhënave ka dalë që shumica e fëmijëve e **përdorin internetin çdo ditë**. Në figurën më poshtë janë paraqitë rezultatet e përgjithshme lidhur me *shpeshtësinë* e qasjes së fëmijëve në internet **dhe kohën** e qëndrimit online. Sipas asaj se çfarë kanë deklaruar fëmijët në pyetësonin e Qendrës FIT, rreth 62% kanë qasje në internet *çdo ditë*, kurse 20% të tjerë qasen në internet *një ose dy herë në javë*.

**Figura 3. Qëndrimi i fëmijëve në internet**



Prej atyre që kanë qasje çdo ditë, 66% e tyre qëndrojnë 1-2 orë online, kurse 24% të tjerë kanë deklaruar se qëndrojnë 2 – 3 orë online. Rreth 11% të tjerë (7% + 4%) qëndrojnë çdo ditë mbi 3 orë gjatë në internet. Nga Akademia Amerikane e Pediatriisë rekomandojnë që fëmijët e moshës deri 16 vjeç, nuk duhet të qëndrojnë në internet më gjatë se dy orë kohë brenda ditës.

## Aktivitetet e fëmijëve në internet

Përmes pyetësorit tonë jemi përpjekur të kuptojmë se për çfarë e përdorin fëmijët internetin më shumë. Kjo për faktin se duke monitoruar atë se çfarë bëjnë fëmijët në internet, prindërit mund të vlerësojnë edhe shkallën e rrezikshmërisë nga të qenurit online. Në këtë aspekt, hulumtime të ndryshme kanë gjetur se fëmijët që e përdorin internetin më shumë kanë mundësi që të mësojnë më shumë mirëpo edhe ekspozimi ndaj rrezikut është më i lartë. Prandaj prindërit duhet të luajnë një rol shumë aktiv me fëmijët për tu përkujdesur që ata të ruhen të sigurt në internet dhe të përpiqen që të fuqizojnë mundësitë e fëmijëve të tyre për të fituar njohuri digjitale. Problemet janë më të thella në rastet kur prindërit nuk kanë njohuri të mira dhe, në rastet ekstreme, kur prindërit nuk kanë njohuri fare lidhur me përdorimin e internetit.

## Çfarë bëjnë fëmijët në internet

Përdorimi i internetit nga fëmijët dallon dukshëm krahasuar me të rriturit. Hulumtime nga autorë të huaj të ndryshëm tregojnë që prindërit zakonisht e përdorin internetin për e-mail dhe kërkime në internet, kurse fëmijët për biseda në mes tyre, kryesisht në rrjete sociale, muzikë, lojëra dhe blogje. Rezultatet e nxjerra nga Qendra FIT tregojnë se rrjetet sociale (facebook, twitter, etj.), youtube, dëgjimi i muzikës dhe lojërat e ndryshme në internet janë aktivitetet më të shpeshta në internet nga fëmijët e Prishtinës. Me gjithë mundësitë e mira që ofrojnë këto rrjete sociale për komunikim dhe për tu argëtuar, për gjeneratat e reja paraqiten edhe rreziqe të natyrave të ndryshme që te të rinjtë mund të ndikojnë shumë negativisht. Kjo për faktin se jo të gjithë fëmijët kanë aftësi digjitale të mira për të menaxhuar privatësinë dhe sekretet personale. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitë përgjigjet e fëmijëve të anketuar lidhur me aktivitetet e tyre online.

**Tabela 5. Aktivitetet e fëmijëve në internet**

Përdorimi	Çfarë ju pëlqen më së shumti të bëni në internet?					Në përqindje	
	Të gjithë	Meshkujt	Femrat	mosha 9-12 vjeç	mosha 13-16		
Facebook	74	80	68	71	79		
YouTube	66	70	62	65	68		
Çat - Mesenxher	65	38	33	27	48		
Muzikë	63	60	67	61	65		
Lojëra	50	54	45	59	36		
Kërkim në web	32	34	30	26	41		
Tjetër / Nuk e di	7	7	7	5	11		

Siç shihet nga tabela aktiviteti më i popullarizuar i fëmijëve në internet është Facebook-u me 74%, i pasuar nga YouTube dhe Çat-Messenxher me 66 respektivisht 65%. Një numër i konsiderueshëm i sajteve vendosin restriksione për moshën e lejuar të fëmijëve para se ata të hapin llogari. Kjo moshë është zakonisht 13 vjeç. Mirëpo nga rezultatet e marra vërehet qartë se këto kritere nuk janë shumë efikase. Rreth 58% e fëmijëve të moshës nën 13 vjeç janë deklaruar se aktiviteti kryesor i tyre në internet është Facebook ose Twitter. Kjo dëshmon qartë se shumica e fëmijëve kanë llogari në Facebook, edhe përkundër restriksioneve në moshë për hapjen e llogarisë. Ndër çështjet kryesore për shqetësim është se shfrytëzimi i këtyre rrjeteve sociale nga mosha shumë e re të cilët nuk janë në gjendje të kufizojnë të dhënat e tyre personale (rregullimi i privatësisë) dhe nuk dinë si të bllokojnë personat e tjerë që atyre mund të ju dërgojnë mesazhe të padëshirueshme. Të dhënat personale, si p.sh. adresa, numri i telefonit, e-mail adresa rekomandohet që të mos bëhen publike nga fëmijët.


Të dhënat e Qendrës FIT tregojnë se ekzistojnë dallime për nga preferencat e fëmijëve për të qëndruar online. Për shembull, vajzat preferojnë më shumë *muzikën*, kurse grupmoshat 9-12 vjeç preferojnë shumë më shumë lojërat. Përveç muzikës, të gjitha kategoritë lidhur me aktivitetet në

internet janë selektuar më shumë nga meshkujt. Dallimet më të thella në preferenca për nga gjinia apo moshë janë në përdorimin e Facebookut dhe Lojërave.

Sipas të dhënave nga anketa e Qendrës FIT, Facebooku është sajti social kryesor për komunikim nga fëmijët. Kjo vërehet edhe me shkallën e lartë të "shokëve" (anglisht *friends*) që ata kanë në profil. Adoleshentët shpeshherë janë të shpejtë për të shtuar emra të rinj si "shokë" në Facebook, dhe kështu rrisin pasigurinë e tyre dhe zbulojnë informacion personal për të panjohurit. Në grafikun më poshtë, me ngjyrë të kuqe janë paraqitur fëmijët sipas moshës, të cilët kanë mbi 400 shokë. Shihet nga grafiku se mbi 40% e fëmijëve të moshës 11 vjeç e më shumë kanë deklaruar se kanë mbi 400 shokë në profil, kurse 19% kanë deklaruar se kanë 200 - 400 shokë. Trendi i fëmijëve të moshës së re, 9-11 vjeç, të cilët kanë mbi 400 shokë, tregon një rritje rapide (prej 9% moshë 9 vjeç, në 40% moshë 11 vjeç).

**40%** e fëmijëve të moshës 11 vjeç e më shumë, kanë deklaruar se kanë mbi 400 'miq' në profilin e tyre të Facebook/Twitter.

Figura 4. Sa shokë i keni në Facebook ose Twitter? (Sa përafërsisht?)



Kjo është shqetësuese për faktin se çdo postim shihet dhe lexohet nga qindra persona që fëmija i ka në profil dhe se fëmijët e grupmoshave të reja nuk kanë njohuri bazike lidhur me vendosjen e

privatësisë në profilin e tyre. Bërja publike e profilit në rrjetet sociale nënkupton që secili mund të shohë informatat personale të postuara nga fëmijët. Kjo paraqet një ekspozim të lartë të rrezikut për fëmijët dhe për familjarët e tyre. Postimet e fëmijëve mund të lexohen apo shikohen edhe nga persona të padëshiruar nga fëmijët dhe me kalimin e kohës ato postime edhe mund bëhen pengesë për karrierë. Njëherit, në profile të hapura por edhe në profilin e tyre nga miqtë e tyre, mund të postohen edhe gjëra nga persona të tretë dhe këto pastaj të shikohet nga qindra persona të tjerë. Të dhënat personale të bëra publike mund të regjistrohen nga kontaktet e fëmijëve, të ripunohen dhe të shpërndahen sërish. Fëmijët duhet të vetëdijesohen lidhur me benefitet dhe rrezikun që lidhet me postimin e përmbajtjeve të ndryshme online. Kjo aq më shumë edhe për faktin se prindërit zakonisht nuk kanë mundësi që vazhdimisht të mbikëqyrin aktivitetet e fëmijëve. Mirëpo ata duhet të diskutojnë me fëmijët dhe të pajtohen rreth kufijve dhe rregullave të qasjes online, për kohën dhe faqet që ata mund të vizitojnë.

Facebook në fund të qershorit 2012 kishte 955 milion përdorues aktiv dhe numri vazhdon të rritet çdo ditë. Në mes të këtyre miliona përdoruesve, shumë prej tyre përdorin të dhëna personale të rreme me qëllim për t'u shoqëruar dhe takuar me të rinj, takime të cilat shpeshherë sjellin rreziqe të ndryshme.

## Komunikimi në rrjetet sociale

Interneti ka ndryshuar shumë jetën e fëmijëve dhe stilin e jetesës. Në ditët e sotme, shumë fëmijë kalojnë orë të tëra gjatë ditës online në rrjete sociale. Rrjetet më të popullarizuara nga të rinjtë jo vetëm në Kosovë por në mbarë botën janë Facebook, Twitter, MySpace, Hi5, LinkedIn, Flickr dhe Windows Live. Ato janë duke u bërë gjithnjë e më të përsosura sa i përket mundësisë së ndarjes së informacioneve me palët e tjera dhe ofrojnë një mundësi të shkëlqyeshme për komunikim. Këto rrjete po integrohen gjithnjë e më tepër edhe në telefona mobil (p.sh. në telefona të mençur apo anglisht *smart phone*) duke ofruar kështu një mundësi të shkëlqyeshme për të shkëmbyer mesazhe, fotografi, filmime, informacione, adresa, etj. Brenda një kohe shumë të shkurtër dhe duke ofruar mundësi të shpërndarjes shumë të shpejtë.


Me gjithë mundësitë e mira që ofrojnë këto rrjete sociale, paraqiten edhe rreziqe të natyrave të ndryshme që te të rinjtë mund të ndikojnë shumë negativisht. Për shembull, shkarkimi i një video apo fotografie mund të bartë viruse të fshehura; postimi i fotografive ju jep mundësi të tjerëve për të manipuluar me fotografitë e postuara; në rrjete sociale shpeshherë persona të ndryshëm ushtrojnë dhunë online (sajberdhunë); ka të atillë që krijojnë profile apo edhe uebfaqe të rrejshme me qëllim që të shantazhojnë dikë; përdorimi i kamerës gjatë bisedave ju ofron keqbërësve një mundësi shumë të mirë për të bindur fëmijët që të takohen me ata. Gjatë këtyre takimeve fëmija mund të lëndohet keq, ngacmohet, dhunohet apo edhe të rrëmbehet. Është e lehtë të gënjëhet online dhe fëmijët lehtë mund të bien viktimë e keqbërësve, kurse pasojat mund të jenë afatgjatë. Me pak fjalë, rrjetet sociale ofrojnë mundësi të mëdha për keqbërësit e ndryshëm dhe fëmijët janë shumë të ekspozuar

në rreziqe të ndryshme gjatë përdorimit të tyre. Prandaj rritja e njohurive të fëmijëve lidhur me rrezikun dhe sigurinë në internet është me rëndësi të madhe. Fëmijët duhet të mësojnë shumë më shumë lidhur me rregullimin e privatësisë në profilet e tyre në internet dhe lidhur me postimet që ata bëjnë. Ky hulumtim i Qendrës FIT ofron evidencë lidhur me aktivitetet e fëmijëve të Prishtinës në internet përfshirë aktivitetin në rrjetet sociale dhe ekspozimin e tyre në këto rrjete. Sipas të dhënave ka dalë që shumë fëmijë të Prishtinës e falsifikojnë datëlindjen e tyre për të plotësuar kriterin e moshës me qëllim të hapin profile në Facebook apo Twitter. Në pyetjen se ...

*“A keni llogari tuajën në Facebook ose Twitter?”*

mbi 87% e fëmijëve janë përgjigjur se kanë llogari të veten në të vetin në Facebook ose Twitter. Rreth 68% e fëmijëve nën moshën 13 vjeç janë deklaruar se kanë llogari në Facebook ose Twitter, edhe përkundër kufizimeve nga këto sajte që moshat e këtilla nuk janë të lejuara të hapin llogari.

**Figure 5. A keni llogari tuajën në Facebook ose Twitter?**




Bazuar në të dhënat nga ky pyetësor ka dalë që në përgjithësi djemtë janë më të apasionuar për aktivitet në Facebook ose Twitter. Rreth 92% e djemve kanë deklaruar se kanë llogari përkundër 83% të vajzave. Gjithashtu 77% e grupmoshës 9 – 10 vjet janë deklaruar se kanë profil në këto rrjete sociale. Nga mosha 10 deri në moshën 14 vjeç nuk vërehet se ka ndonjë dallim për tu përmendur për sa i përket përqindjes së atyre që kanë profil në këto rrjete. Në përgjithësi afër 90% e tyre kanë ‘profile të hapura’. Këto përqindje në mesatare janë shumë më të larta krahasuar me vendet e tjera, të publikuara në raportin e 25 shteteve të Europës. Sipas këtij raporti, rrjetet sociale janë më të popullarizuara në Holandë (80%), Lituani (76%) e Danimarkë (85%), ndërsa pak më pak në Rumani (46%), Turqi (49%), dhe Gjermani (51%).

## Lojërat Online

Në jetën e përditshme fëmijët bëjnë një mori aktivitetesh në internet, varësisht nga mosha, gjinia dhe karakteristika të tjerë të individëve. Disa prej këtyre gjërave janë me benefit, mirëpo jo të gjitha.

Lojërat në internet janë një nga aktivitetet e tyre të preferuara. Sipas të dhënave ka dalë që 89% e fëmijëve kanë luajtur lojëra në internet, vetëm apo kundër kompjuterit. Prej atyre që kanë luajtur lojëra në internet, 26% janë deklaruar se kanë luajtur *çdo ditë apo gati çdo ditë* kurse 27% kanë luajtur *një ose dy here në javë*.

**Figure 6. Nëse jeni përgjigjur me po, sa shpesh keni luajtur me lojëra në internet**



Sipas përgjigjeve të fëmijëve nuk ka rezultuar që ka dallime të rëndësishme në mes të vajzave dhe djemve, por ka diferenca për sa i përket shpeshtësisë dhe kohës që ata kalojnë në lojëra në internet. Nga tabela më poshtë shihet se meshkujt janë shumë më aktivë me lojëra në internet. Njëherit, fëmijët e moshave të reja kyçen më shumë në lojëra online, por ata të moshave adoleshente qëndrojnë më gjatë duke luajtur lojëra online.

**Tabela 6. lojëra në internet (vetëm apo kundër kompjuterit / Nëse jeni përgjigjur me po, sa shpesh keni luajtur me lojëra në internet në 12 MUAJT E KALUAR?**

Kategoria	Meshkujt	Femrat	9-12 vjeçar	13-16 vjeçar	Gjithsejt
Çdo ditë apo gati çdo ditë	34.3	17.5	23.5	30.7	26
Një ose dy here në javë	31.7	21.8	30.0	22.4	27
Një ose dy here në muaj	9.5	11.8	7.0	15.8	11
Jo shpesh	21.6	46.8	37.0	28.5	34
Nuk e di	2.9	2.1	2.5	2.6	3
Gjithsejt					100

## Rreziku në internet

### Përvojat e këqija të fëmijëve në internet

Në kapitujt paraprak treguam se fëmijët janë duke e përdorur internetin në masë të madhe dhe se për shumë prej tyre surfimi në internet është aktiviteti kryesor në kohën e epokës digjitale. Shumë prej aktiviteteve të fëmijëve në internet u japin atyre njohuri mjaft të mira dhe të dobishme, mirëpo njëkohësisht qasja në mënyrë jo të sigurt në këto aktivitete shpesh mund të shpie deri tek rreziku potencial për fëmijët. Për shembull, shpeshherë në webfaqet me lojëra, apo në rrjete sociale, youtube ose faqe të tjera ku fëmijët kalojnë mjaftë kohë, paraqiten materiale përmbajtja e të cilave është e papërshtatshme për fëmijë të moshave të reja. Kjo tregon se prindërit dhe kujdestarët e fëmijëve duhet ta kenë të qartë se janë pikërisht ata që duhet pasur kujdes që t’ju qëndrojnë afër fëmijëve të tyre, sepse fëmijët shpesh nuk janë të vetëdijshëm që veprimet e tyre në internet mund të kenë pasoja negative për ta apo fëmijët e tjerë.

Për të qenë pyetësi sa më i përshtatshëm për përgjigje, fëmijët fillimisht janë pyetur se a e përdorin internetin, për çfarë e përdorin internetin më së shumti, sa shpesh e përdorin internetin etj., dhe pastaj kemi kaluar tek pyetjet lidhur me rreziqet në internet. Në pyetjet me shprehje më të ndërlikuar është dashur të ipen shpjegime shtesë për terma të caktuar si ‘përmbajtje erotike’, ‘shqetësuar’, ‘veprime të dëmshme ose të pakëndshme’. Shpjegimet përveç se janë bërë në pyetësor janë bërë edhe ma rastin e mbajtjes së pyetësorit duke ju sqaruar fëmijëve se çfarë nënkuptojnë këto terminologji.

Pasi kemi kaluar pjesën e shpjegimeve dhe paqartësive eventuale, fëmijët janë pyetur:

*‘A keni hasur ndonjëherë përmbajtje të dëmshme dhe ilegale në Internet?’*

Rezultatet nga kjo pyetje janë treguar në tabelën më poshtë.



**Tabela 7. Rreziku në internet, sipas gjinisë dhe grupmoshës**

Kategoria	P O	J o	Nuk e di	S 'kam përgjigje	G jithsejt
Mashkull	48.0	39.6	4.8	4.8	100
Femër	35.5	52.3	7.2	4.9	100
9-12 vjeçar	31.9	57.7	3.9	6.5	100
13-16 vjeçar	57.8	27.1	9.2	6.0	100
G jithsejt	42.1	45.6	6.0	6.3	100

Siç mund të shihet nga tabela më shumë 48% e djemve kanë hasur në përmbajtje të dëmshme apo ilegale kundrejt 36% e vajzave. Po ashtu prirje për tu qasur në përmbajtje të dëmshme dhe ilegale në internet më shumë kanë deklaruar se kanë fëmijët e grupmoshës 13-16 vjeçare krahasuar me ata të moshës më të vogël. Sido që të jetë, mbetet shqetësues fakti që pothuajse gjysma e fëmijëve (48% e fëmijëve të gjinisë mashkullore dhe 35% e asaj femërore) deklarojnë të kenë hasur në përmbajtjeje të dëmshme apo ilegale në internet.

Në përgjithësi vetëm rreth 12% e fëmijëve kanë zgjedhur opsionet ‘Nuk e di’ dhe ‘S’kam përgjigje’.

## **Përmbajtjet Seksuale**

Përmbajtjet pornografike në web janë duke u rritur gjithnjë e më shumë dhe nga dita në ditë ky fenomen është duke u bërë edhe më i rëndë. Ky fakt rrit gjasat që fëmijët të ekspozohen rastësisht për shkak të të ashtuquajturve sulme ‘spam’ në rrjetet sociale apo viruseve të ndryshme. Nga studime, hulumtime të ndryshme, është konstatuar se mesatarja e moshës kur fëmijët kanë hasur në pamje pornografike është 11 vjeç. Një ndër shqetësimet kryesore të shoqërisë, por veçanërisht të prindërve, është që fëmijët mund të vijnë në kontakt me pamje apo përmbajtje të dëmshme gjatë përdorimit të internetit. Ka shumë mundësi që fëmijët në ditët e sotme të kenë qasje në pamje me përmbajtje shqetësuese. Siç është përmendur edhe më lartë në këtë raport, përdorimi i internetit nga fëmijët është mjaft i shpeshtë dhe po ashtu edhe mundësitë e qasjes në internet (për shembull në: shtëpi, shkollë, internet kafé, telefon, etj.) janë të shumta. Gjërat të cilat fëmijët mund t’i shohin në internet mund të jenë prej atyre të zakonshme e deri tek ato të dëmshme, shqetësuese dhe ilegale. Këto pamje mund të jenë të dëmshme ose jo. Mirëpo, një ndër rreziqet më serioze për fëmijët gjatë shfrytëzimit të internetit mbetet pornografia.

Për shkaqe etike në anketimin e zhvilluar nga Qendra FIT me fëmijët e Prishtinës, pyetjet për pornografinë nuk ka pas mundësi që të shprehen në formë eksplicite, në mënyrë që të mos iu tërheqim vëmendjen për një fenomen me të cilin fëmijët mund të mos jenë të njohur. Edhe pse kjo është një ndër çështjet kryesore në këtë kapitull të këtij studimi, terminologjia ‘pornografi’ si e tillë

nuk është përdorur në pyetësin për fëmijët.

Pyetja lidhur me përmbajtjen erotike në internet është bërë në këtë mënyrë:

*JU LUTEM LEXOJENI: Në 12 muajt e kaluar, ju mund të keni parë pamje të ndryshme në internet – fotografi, video, etj. Shpeshherë, këto pamje kanë përmbajtje të papërshtatshme (erotike).*

*Ju ndoshta NUK keni parë diçka të këtillë, ose KENI parë diçka të këtillë: p.sh. në telefonin mobil, në revista, në TV, ose në DVD apo edhe në Internet.*

*- A keni parë DIQKA të ngjashme në 12 MUAJT e kaluar? (p.sh. foto ose video erotike)?*

Rezultatet lidhur me rrezikun nga përmbajtjet erotike në internet për fëmijët, janë treguar në tabelën e mëposhtme.


**Tabela 8. Fëmija ka parë imazhe seksuale online në 12 muajt e fundit, sipas gjinisë dhe grupmoshës**

Kategoria	Po	Jo	Nuk e di	S'kam përgjigje	Gjithsejt
Mashkull	49.7	35.1	6.4	8.8	100
Femër	34.0	53.5	7.3	5.3	100
9-12 vjeçar	39.3	50.1	4.0	6.6	100
13-16 vjeçar	46.6	34.4	11.1	7.9	100
Gjithsejt	42.2	43.8	6.8	7.1	100

Në tabelën 8 shihet se 42% e fëmijëve kanë deklaruar të kenë hasur në video apo foto me përmbajtje erotike. Po ashtu çdo i dyti fëmijë i gjinisë mashkullore, në 12 muajt e fundit, ka parë pamje me përmbajtje erotike. Tek vajzat, kjo përqindje është më e ulët; afërsisht çdo e treta vajzë ka deklaruar se ka hasur në përmbajtje të tillë gjatë përdorimit të internetit. Sa i përket moshës, rreth 40% e fëmijëve 9 deri 12 vjeç, kanë deklaruar se kanë hasur në pamje erotike gjatë qasjes në internet në 12 muajt e fundit, kurse për grupmoshat 13 deri 16 kjo përqindje është edhe më e lartë - rreth 47%.

Për të parë se sa është serioz ky fenomen, ne i kemi pyetur fëmijët se sa shpesh kanë parë ata përmbajtje të tilla në internet. Përgjigjet e tyre janë treguar në figurën më poshtë.

**Figura 7. Fëmijët që kanë parë imazhe seksuale online në 12 muajt e fundit**



Është vërtet shqetësues fakti që rreth 46% e fëmijëve kanë parë sa paku disa herë në muaj foto apo video me përmbajtje erotike. Mesatarisht 13% e fëmijëve, kanë deklaruar të kenë parë përmbajtje të tilla çdo ditë. Derisa 17% janë fëmijë të gjinisë mashkullore, rreth 6% janë femra.

# 42%

e fëmijëve kanë deklaruar se kanë parë përmbajtje erotike, prej të cilëve 13% kanë parë pamje të tilla çdo ditë.

Po ashtu, mund të thuhet se nga kjo dukuri më të prekur janë fëmijët e moshës 13-16 vjeçare (rreth 16%) krahasuar me moshat më të reja 9-12 vjeç (rreth 11%). Në përgjithësi, nga përgjigjet e fëmijëve, ka dalë që kjo dukuri ka prekur të gjithë fëmijët, por më e shprehur duket të jetë tek djemtë e moshës më të rritur.

Se sa janë të dëmshme për shëndetin psikologjik dhe fizik të fëmijëve pamjet e tilla erotike, mbetet për profesionistët e kësaj fushe të jipet përgjigje. Mirëpo, për të pasur një indikacion mbi seriozitetin e kësaj teme, ne i kemi pyetur fëmijët nëse këto pamje (me përmbajtje erotike) i kanë shqetësuar ata. Pyetja është shtruar siç vijon:

*Të shohësh fotografi erotike në internet mund të jetë në rregull ose jo në rregull.*

*Në 12 MUAJT E FUNDIT, a keni parë ndonjë gjë të këtillë që ju ka shqetësuar ju në ndonjë mënyrë? Për shembull, ju ka bërë ju që të ndjeheni keq, i mërzhitur, apo keni menduar se nuk*

është dashtë ti shikoni ato.

Rezultatet të ndara edhe sipas gjinisë janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

**Tabela 9. Shqetësimi në ndonjë mënyrë?**

Kategoria	PO	Jo	Nuk e di	S'kam përgjigje	Gjithsejt
Mashkull	42,0	33,5	10,1	14,4	100
Femër	56,8	24,8	8,8	9,6	100
9-12 vjeçar	57,1	24,4	8,9	9,5	100
13-16 vjeçar	37,2	36,6	10,3	15,9	100
Gjithsejt	47,9	30,0	9,6	12,5	100

Nga tabela 9 shihet qartë se vajzat dhe fëmijët e moshës 9-12 vjeçare janë më të shqetësuar nga shikimi i fotove dhe videove me përmbajtje erotike sesa djemtë dhe fëmijët e moshës më të rritur. Sido që të jetë, pothuajse gjysma (rreth 48%) e fëmijëve në përgjithësi janë të shqetësuar nga shikimi i përmbajtjeve të tilla gjatë shfrytëzimit të internetit.

Sipas Akademisë Amerikane të Pediatriisë fëmijët të moshës nën 10 vjeç kanë nevojë për mbikëqyrje dhe monitorim për të siguruar që ata nuk janë të ekspozuar ndaj materialeve jo të përshtatshme për moshën e tyre. Prindërit duhet të përdorin teknika të ndryshme për të limituar qasjen, uebsitet, dhe aktivitetet, dhe duhet që në mënyrë aktive të jenë të involvuar në përdorimin e internetit nga fëmijët e tyre.

Në tabelën e më poshtme është treguar **lidhja në mes të vendit ku shfrytëzohet interneti** me pyetjen se a kanë parë fëmijët foto apo video me përmbajtje erotike.

**Tabela 10. Shikimi i pamjeve të papërshtatshme erotike kundrejt vendit nga ku qasen fëmijët**

Vendi	A keni parë në 12 muajt e kaluar pamje (video, foto, etj.) me përmbajtje erotike ?			
	Po	Jo	Nuk e di	Preteroj te mos tregoi
A e përdorni internetin në .....? Po				
Dhomë te fjetjes	69.8	56.7	69.8	77.8
Dhomë të ndejës	61.1	59.6	55.8	62.2
Shkollë	8.3	5.1	18.6	17.8
Internet kafé	18.5	9.0	20.9	22.2
Tek shoku	35.5	24.2	32.6	33.3
Tek miqtë (afërmit)	39.3	23.8	44.2	37.8
Vend tjetër (p.sh.: iphone, ipad, etj.)	46.4	32.1	46.5	55.6
Gjithsejt	42.1	44.0	6.8	7.1

Përgjigjet e shumëfishta të mundësuar në këtë pyetje

Për kolonën 'Vendi' janë paraqitur përqindjet e atyre fëmijëve që kanë deklaruar të kenë shfrytëzuar internetin në vende të ndryshme si nga dhoma e fjetjes, dhoma e ndejës, shkolla, internet kafé, tek shoku, tek miqtë/afërmit, apo na ndonjë vend tjetër, p.sh.: iphone, ipad, etj.

Nga kjo tabelë mund të shihet që fëmijët të cilët shfrytëzojnë internetin në *shtëpi* kanë më shumë

gjasa për të hasur në foto apo video me përmbajtje erotike (69.8% në dhomë të fjetjes dhe 61.1% në dhomë të ndejës), krahasuar me fëmijët të cilët e përdorin internetin në lokacione në prezencë të shokëve apo miqve (18% në internet kafé dhe 8.30% në shkollë).

Rezultatet nga përgjigjet e fëmijëve (sipas vendit ku e përdorin internetin) në pyetjen:

*A keni parë ndonjë gjë të këtitillë (foto apo video me përmbajtje erotike) që ju ka shqetësuar ju në ndonjë mënyrë?, janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.*

**Tabela 11. Shikimi i pamjeve të papërshtatshme erotike shqetësuese kundrejt vendit nga ku qasen**

Vendi	A keni parë ndonjë gjë të këtitillë që ju ka shqetësuar ju në ndonjë mënyrë?			
	Po	Jo	Nuk e di	Preferoj të mos tregoi
A e përdorni internetin në .....? Po				
Dhomë të fjetjes	66.0	73.4	73.3	69.2
Dhomë të ndejës	61.3	57.5	70.0	48.7
Shkollë	8.7	11.7	6.7	7.7
Internet kafé	18.7	18.1	23.3	20.5
Tek shoku	36.7	31.9	43.3	43.6
Tek miqtë (afërmit)	38.0	38.3	60.0	30.8
Vend tjetër (p.sh.: iphone, ipad, etj.)	44.0	44.7	43.3	61.5
Gjithsejt	47.9	30.0	9.6	12.5

*Përgjigjet e shumëfishta të mundësuar*

Nga rezultatet në tabelën 11 shihet se pothuajse ngjashëm me pyetjen se gjatë përdorimit të internetit kanë hasur në përmbajtje erotike në internet, edhe në pyetjen nëse këto pamje i kanë shqetësuar ata rezultatet janë të ngjashme. Kjo të thotë se, në përgjithësi fëmijët janë të shqetësuar nga pamjet e tilla, pa marr parasysh vendit ku ata e shfrytëzojnë internetin.

Në tabelën 12 janë paraqitur rezultatet nga përgjigjet e fëmijëve në pyetjen se a kanë parë foto apo video erotike në 12 muajt e fundit.

**Tabela 12. A keni parë në 12 muajt e kaluar pamje (video, foto, etj.) me përmbajtje erotike?**

Sa të vërteta janë këto për ju? S hpesht jam i/e mërziur, trishtuar ose i/e përlotur.	A keni parë në 12 muajt e kaluar pamje (video, foto, etj.) me përmbajtje erotike ?			
	Po	Jo	Nuk e di	Preferoj të mos tregoj
Jo e vërtetë	45.4	52.6	57.1	47.7
Pak e vërtetë	44.2	36.5	40.5	36.4
S humë e vërtetë	10.5	10.9	2.4	15.9
Gjithsejt	100.0	100.0	100.0	100.0

Ndërlidhja e përgjigjeve të fëmijëve në këto dy pyetje tregon se fëmijët të cilët shpesh e ndiejnë veten të mërziur apo trishtuar (44.19% + 10.47% = 54.66) kanë gjasa më të mëdha për të hasur në foto apo video me përmbajtje erotike sesa ata që nuk ndihet të mërziur apo trishtuar (45.35%).

## Dhuna përmes internetit

Një nga format më të shpeshta të rrezikut që mund të hasin fëmijët gjatë përdorimit të internetit është edhe e ashtuquajtura sajberdhuna, apo dhuna (shqetësimi, ngacmimi, apo ndonjë veprim tjetër që shqetëson fëmijët nga ana e bashkëmoshatarëve të tyre) përmes internetit. Kjo formë e dhunës për fëmijët, sot, është çështje kryesore për shqetësim sa i përket sigurisë në internet. Dhuna përmes internetit mund të jetë shkaktar i problemeve të ndryshme për fëmijët dhe shpeshherë është vështirë edhe të kuptohen fëmijët sa janë duke përjetuar ndonjë lloj dhune. Pasojat janë të shumta, duke filluar nga frika, shantazhimi, depresioni, etj. Tortura e bërë përmes mjeteve elektronike ka filluar të bëhet dukuri e shpeshtë tek fëmijët. Kjo bëhet nëpërmjet dërgimit të tekst mesazheve në telefon mobil, në Facebook, YouTube, shkollë dhe medime të tjera. Sajberdhuna mund të jetë edhe më e keqe se sa dhuna fizike, për faktin se nga kjo formë e dhunës fëmijët nuk mund të ikin, ajo është publike dhe është permanente<sup>6</sup>.

Termi sajberdhunë apo dhunë përmes internetit është i vështirë për tu përshkruar dhe mund të nënkuptoj gjëra të ndryshme për grupe të ndryshme të njerëzve. Ashtu sikur edhe termi ‘pornografi’, termi sajberdhunë nuk është përdorur në pyetësin për fëmijë. Në vend të kësaj ne e kemi përkufizuar siç vijon:

*“Shpeshherë fëmijët ose adoleshentët bëjnë ose thonë gjëra të dëmshme ose të pakëndshme. Kur njerëzit veprojnë kështu me dikë, këtë mund ta bëjnë në disa mënyra. P.sh. ballë për ballë (personalisht), përmes telefonit mobil (mesazheve, thirrjeve, videove) apo përmes internetit (e-mailave, mesazhe elektronike, rrjeteve sociale, chat-eve).”*

Gjatë plotësimit të pyetësit, intervistuesi ju ka shpjeguar nxënësve se kjo formë a aktivitetit apo kjo ngjarje mund të ndodh personalisht/ballë për ballë, përmes telefonit mobil (mesazheve, thirrjeve, videove) apo përmes internetit (e-mailave, mesazhe elektronike, rrjeteve sociale, chat-eve).

Pas kësaj, fëmijët janë pyetur nëse dikush ka vepruar tek ata në mënyrë të tillë të dëmshme ose të pakëndshme në 12 muajt e fundit. Përgjigjet nga kjo pyetje janë paraqitur në tabelën e treguar më poshtë.

---

<sup>6</sup> Shiqo filmin e prodhuar nga ‘Childnet International’ në linkun: [www.digizen.org/cyberbullying/film.aspx](http://www.digizen.org/cyberbullying/film.aspx)

**Tabela 13. A ka vepruar dikush tek ju në mënyrë të tillë të dëmshme ose të pakëndshme në 12 muajt e fundit?**

Kategoria	Po	Jo	Nuk e di	Preferoj të mos tregoj	Gjithsejt
Mashkull	39.5	55.4	3.4	1.8	100
Femër	34.3	61.6	3.0	1.0	100
9-12 vjeçar	42.6	55.6	1.6	0.3	100
13-16 vjeçar	28.6	62.5	5.7	3.2	100
Gjithsejt	37.0	58.3	3.2	1.4	100

Nga rezultatet e treguara në tabelën 13 shihet se kjo dukuri është mjaft e shprehur tek të rinjtë (37% e fëmijëve kanë deklaruar se dikush ka vepruar ndaj tyre në mënyrë të dëmshme ose të pakëndshme në 12 muajt e fundit). Rreth 39% e fëmijëve të gjinisë mashkullore kanë deklaruar se ndaj tyre në 12 muajt e fundit ka ndodhur të jetë vepruar në mënyrë të dëmshme apo të pakëndshme. Ndërsa tek femrat kjo dukuri është më e rrallë, ndaj çdo të tretit fëmijë të gjinisë femërore është vepruar në këtë mënyrë të pakëndshme apo të dëmshme.

Nga këto rezultate shihet se fëmijët e moshës më të vogël kanë më shumë gjasa (rreth 43% e fëmijëve nga mosha 9 deri 12 vjeç) të jenë të ekspozuar ndaj sjelljeve të tilla të dëmshme ose të pakëndshme sesa ata të moshës më të rritur (rreth 39% e fëmijëve nga mosha 13 deri 16 vjeç).

## Format e sajberdhunës

Për të kuptuar më mirë sajberdhunën krahasuar me format e tjera të dhunës, fëmijët që janë përgjigjur *'se dikush ka vepruar ndaj tyre në formë të dëmshme ose të pakëndshme'*, janë pyetur edhe me një pyetje tjetër se si ka ndodhur kjo, duke specifikuar në pyetësor këto mundësi:

- Përmes rrjeteve sociale,
- Përmes mesazheve ne internet,
- Çat – Mesenxher,
- Me e-mail,
- Në webfaqe të lojërave,
- Në ndonjë mënyrë tjetër në internet dhe
- Nuk e di.

Përgjigja e fëmijëve se si është ushtruar dhunë ndaj tyre janë si vijon:



**Tabela 14. Nëse ju ka ndodhur juve një gjë e tillë (e dëmshme ose e pakëndshme në internet), në cilën prej këtyre ju ka ndodhur kjo:**

Kategoria	Frekuenca	Përqindja
Përmes rrjeteve sociale	104	41.1
Çat – Mesenxher	92	37.6
Përmes mesazheve në internet	82	33.3
Me e-mail	37	15.2
Në webfaqe të lojërave	36	14.8
Në ndonjë mënyrë tjetër në internet	29	11.9
Nuk e di	29	11.9
<b>Totali</b>	<b>243</b>	<b>-</b>

*Përgjigjet e shumëfishta të mundësuar*

Nga rezultatet e treguara më lartë shihet se mënyrat kryesore përmes të cilave është ushtruar dhunë përmes internetit janë ‘përmes rrjeteve sociale (rreth 41%)’, ‘Çat-in ose Mesenxher –in (rreth 38%)’ dhe ‘Përmes mesazheve në internet (rreth 33%)’.

Duke parë se përqindja më e lartë e fëmijëve kanë deklaruar se ndaj tyre është ushtruar dhunë gjatë shfrytëzimit të rrjeteve sociale, është me rëndësi të shihet se cila shtresë e fëmijëve është më e rrezikuar nga kjo. Më poshtë është treguar përqindja e atyre fëmijëve të ekspozuar ndaj këtij fenomeni sipas gjinisë dhe moshës.

**Tabela 15. Nëse ju ka ndodhur juve një gjë e tillë (e dëmshme ose e pakëndshme në internet):... përmes rrjeteve sociale.**

Kategoria	P o	J o
Mashkull	45.4	54.6
Femër	35.7	64.3
9-12 vjeç	48.5	51.5
13-16 vjeç	25.6	74.4
<b>Gjithsejt</b>	<b>41.1</b>	<b>58.9</b>

Nga tabela 15 shihet se 45% e djemve kanë deklaruar se ndaj tyre është ushtruar dhunë përmes rrjeteve sociale, krahasuar me rreth 36% të fëmijëve të gjinisë femërore.

Ndërsa janë fëmijët e moshës më të vogël ata ndaj të cilëve është ushtruar dhunë më shumë (rreth 49%) sa atyre në moshë më të rritur (rreth 26%). Kjo e fundit vjen si befasi, duke ditur se Facebook është rrjeti social me i popullarizuar në vendin tonë, dhe se për të hapur llogari në këtë rrjet social fëmijët duhet të jenë së pakut 13 vjeçar.



## Përballja me sajberdhunën

Se sa shpejt fëmijët i kalojnë përvojat e këqija nga ngacmimet përmes internetit varet edhe nga efikasiteti i teknikave të përballimit të këtyre përvojave. Ndoshta njëra ndër metodat më të mira për përballimin e pasojave të ngacmimit online nga moshatarët është duke kërkuar mbështetje sociale. Për të zbuluar dhunën e cila mund të jetë e pranishme nevojitet të bisedohet me fëmijët, të pyeten fëmijët në mënyrë specifike se çfarë bëjnë ata në internet, çfarë mendojnë për sajberdhunën, dhe t'ju bëhet e qartë që ata duhet të tregojnë nëse tek ata ose shokët e tyre dikush ushtron dhunë online.

Për të parë se në çfarë mënyre janë përballur fëmijët me problemin në raste të tilla, në pyetësor është vendosur pyetja : “A keni biseduar me dikë lidhur me atë çka ka ndodhur?”

Përgjigjet nga kjo pyetje janë treguar në tabelën 16, treguar më poshtë.

**Tabela 16. A keni biseduar me dikë lidhur me atë çka ka ndodhur?**

Kategoria	P o	J o	Nuk e di	P referoj të mos tregoj	G jithsejt
Mashkull	54.7	35.8	5.1	4.4	100
Femër	72.2	17.6	3.7	6.5	100
9-12 vjeçar	66.9	24.1	3.6	5.4	100
13-16 vjeçar	53.2	35.4	6.3	5.1	100
G jithsejt	62.5	27.8	4.5	5.3	100

Nga rezultatet e treguara më lart shihet se shumica e vajzave (rreth 72%) dhe fëmijët e moshës nga 9 deri 12 (rreth 67%) preferojnë që nëse gjatë shfrytëzimit të internetit dikush nga moshatarët ka vepruar në mënyrë të dëmshme apo të pakëndshme ndaj tyre të bisedojnë me dikë lidhur me atë çka ka ndodhur. Edhe pse përqindja e djemve dhe fëmijëve me moshë nga 13 deri 16 vjeç që kanë biseduar me dikë lidhur me atë çka ka ndodhur është më e vogël, prapë se prapë me mbi gjysma e tyre kanë biseduar me dikë pas ndonjë rasti të tillë.

Ndërsa për të parë sa është ky fenomen i përhapur, ne i kemi pyetur se sa shpesh fëmijët janë ‘ngacmuar’ online. Përgjigjet e fëmijëve janë siç vijon:

**Tabela 17. “A keni bërë ndonjëherë nga këto gjëra që u përmendën më lart, Nëse po, atëherë sa shpesh i keni bërë këto gjëra?”**

Kategoria	Frekuenca	Përqindja
Çdo ditë apo gati çdo ditë	12.0	5.6
Një ose dy herë në javë	7.0	3.3
Një ose dy herë në muaj	17.0	8.0
Jo shpesh	70.0	32.9
Nuk e di	59.0	27.7
Preferoj të mos tregoj	48.0	22.5
<b>Gjithsejt</b>	<b>213.0</b>	<b>-</b>

Nga këto rezultate shihet se afërsisht 6% e fëmijëve janë ngacmuar çdo ditë apo gati çdo ditë (u është thënë diçka e pakëndshme apo e dëmshme) nga moshatarët e tyre në internet. Ndërsa vetëm rreth 3% e tyre janë ngacmuar një ose dy herë në javë, dhe 8% e tyre një ose dy herë në muaj. Afërsisht çdo i treti fëmijë ka deklarua se ‘jo shpesh’ i është thënë diçka e pakëndshme apo e dëmshme në internet. Ndërsa afërsisht 28% e fëmijëve kanë zgjedhur opsionet ‘nuk e di’ dhe 22% ‘preferoj të mos tregoj’.

Problemet e shkaktuara përmes dhunës online duhet të merren shumë seriozisht nga prindërit dhe të bisedohet me fëmijët para sa tu ndodh diçka e tillë atyre në mënyrë që ata të dinë si të reagojnë para se gjërat të komplikohen, dhe të dinë se si të largohen nga veprimet apo ngjarjet e tilla. Njëherit, prindërit duhet të jenë të vendosur para fëmijëve për faktin se kur fëmijët janë të gatshëm dhe mund të përdorin internetin apo ti shikojnë faqet e caktuara në internet, pastaj të vendosin rregulla të prera e të qarta dhe të vendosin konsekuencat për fëmijët (nëse fëmijët nuk respektojnë rregullat e vendosura).

## Takimi me njerëz të rinj

Ndër brengat më të mëdha të publikut dhe politikë-bërësve për sigurinë e fëmijëve në internet është fakti që fëmijët mund të njoftojnë dikë për herë të parë në internet, që më pas mund të abuzohen nga ata në takim ballë për ballë.

Edhe pse në hulumtimet e bëra në Europë thuhet se rreziku nga dëmtimi apo shqetësimi që mund të vij nga takimi ballë për ballë me dikë që së pari fëmijët kanë takuar online është i vogël. Ky hulumtim thotë se kjo ndodh për shkak se fëmijët kryesisht përdorin internetin për të zgjeruar rrjetin e tyre të shokëve, dhe është një numër shumë i vogël që shfrytëzon komunikimin online për tu takuar me të rriturit (qoftë me ose pa qëllim). Për me tepër është e paqartë se çfarë rreziqesh saktësisht mund të shkaktohen nga takimi me njerëz që nuk i kanë takuar më parë përmes internetit (siç mund të jenë mashtrimi apo shfrytëzimi përmes internetit apo edhe ballë për ballë).

Në pyetësonin e hartuar për këtë hulumtim ne kemi futur gjashtë pyetje lidhur me këtë temë për të parë se cilat kategori të fëmijëve janë më të rrezikuar nga kjo dukuri dhe mënyrat më të shpeshta si vihet deri tek ky rrezik. Pyetja është shkruar duke filluar me: “A mundeni te tregoni....” në mënyrë që fëmijët mos ta ndiejnë veten të obliguar për të dhënë përgjigje, duke pasur parasysh ndërlikueshmërinë e kësaj pyetjeje dhe ndjeshmërinë e fëmijëve. Pastaj kjo është pasuar me pjesën tjetër te pyetjes:

*“...a keni pasur ndonjëherë kontakt përmes internetit me dikë që nuk e keni takuar më parë personalisht? (Shembull: përmes Mesengerit apo Facebook-ut)”*

Rezultatet nga kjo pyetje janë treguar në tabelën më poshtë.

**Tabela 18. Pyetja: A keni pasur ndonjëherë kontakt përmes internetit me dikë që nuk e keni takuar më parë personalisht?**

Kategoria	Po	Jo	Nuk e di	Preferoj të mos tregoj	Gjithsejt
Mashkull	73.5	24.9	0.9	0.6	100
Femër	57.7	40.7	1.0	0.7	100
9-12 vjeçar	58.0	39.6	1.6	0.8	100
13-16 vjeçar	78.1	21.5	0.0	0.4	100
Gjithsejt	65.9	32.5	1.0	0.6	100

Nga tabela e treguar më lartë shihet se shumica e fëmijëve (rreth 66% e fëmijëve në përgjithësi) kanë deklaruar se së paku njëherë kanë pasur kontakt përmes internetit me dikë që nuk e kanë takuar më parë personalisht. Rreziku nga kontaktet e tilla përmes internetit është më i lartë për fëmijët e gjinisë mashkullore (rreth 73%) dhe fëmijët e moshës 13 deri 16 vjeçare (rreth 78%), krahasuar me fëmijët e gjinisë femërore dhe fëmijët me moshë nga 9 deri 16 vjeç (me rreth 58%).

Për ata fëmijë të cilët janë përgjigjur me ‘Jo’ në pyetjen se a kanë pasur ndonjëherë kontakt përmes internetit me dikë që nuk e kanë takuar më parë personalisht, ne i kemi udhëzuar që t’i kalojnë pesë pyetjet e radhës për këtë temë, dhe të vazhdojnë me pyetjen tjera për sigurinë në internet.

Fakti që fëmijët kanë kontaktuar përmes internetit dika që më parë nuk e kanë njohur mund të jetë zbavitëse për ta mirëpo edhe mjaft e rrezikshme. Ndër qëllimet e këtij hulumtimi është edhe identifikimi i rreziqeve që vijnë nga përdorimi i internetit nga fëmijët. Brenga më e madhe është se kontaktet e tilla përmes internetit mund të vazhdohen edhe me kontaktet e drejtpërdrejta (ballë për ballë ose ‘offline’). Andaj për të parë se sa është e shprehur kjo tendencë tek ne, në pyetësonin tonë kemi vendosur pyetjen e treguar në vijim.

Fëmijët që janë përgjigjur me Po në pyetjen e cekur më lart i kemi udhëzuar që të përgjigjen në

pyetjen siç vijon:

*“A keni takuar ndonjëherë dikë personalisht, të cilin së pari e keni kontaktuar përmes internetit?”*

Rezultatet nga kjo pyetje janë paraqitur në tabelën e më poshtme:

**Tabela 19. A keni takuar ndonjëherë dikë personalisht, të cilin së pari e keni kontaktuar përmes internetit?**

Kategoria	Po	Jo	Nuk e di	Preferoj të mos tregoj	Gjithsejt
Mashkull	63.8	31.5	3.2	1.6	100
Femër	50.5	46.8	1.6	1.1	100
9-12 vjeçar	48.7	48.3	1.7	1.3	100
13-16 vjeçar	69.4	25.6	3.5	1.5	100
Gjithsejt	58.1	38.0	2.5	1.4	100

Nga tabela e treguar sipër, shihet se sa më të rritur janë fëmijët gjasat janë më të mëdha që ata të takojnë dikë personalisht të cilin së pari e kanë kontaktuar përmes internetit, pra fëmijët e moshës 9 deri 12 vjeçare (rreth 49%) krahasuar me ata të moshës 13 deri 16 vjeç (rreth 69%). Po ashtu fëmijët e gjinisë mashkullore kanë më shumë gjasa (rreth 64%) për takime të tilla sesa fëmijët e gjinisë femërore (rreth 50%).

Më tutje, për të parë se sa është kjo dukuri e zakonshme për fëmijët, në pyetësor kemi vendosur pyetjen siç vijon:

*“Dhe sa persona të ndryshëm i keni takuar në këtë mënyrë në 12 MUAJT E FUNDIT, (nëse ndonjë)?”*

Rezultatet nga kjo pyetje janë treguar në tabelën e mëposhtme:

**Tabela 20. Dhe sa persona të ndryshëm i keni takuar në këtë mënyrë në 12 MUAJT E FUNDIT, (nëse ndonjë)?**

Kategoria	1 - 2	3 - 4	5 - 10	Më shumë se 10	Gjithsejt
Mashkull	30.9	25.1	9.9	14.4	19.8
Femër	41.9	20.4	3.0	7.8	27.0
9-12 vjeçar	35.6	23.7	5.0	14.6	21.0
13-16 vjeçar	35.1	22.5	9.4	8.4	8.4
Gjithsejt	35.4	23.2	7.1	11.7	22.7

Nga rezultatet e treguara më sipër shihet se fëmijët e gjinisë mashkullore kanë më shumë tendencë për tu takuar personalisht me dikë që së pari e kanë kontaktuar përmes internetit sesa fëmijët e gjinisë femërore. Ndërsa mosha nuk duket të jetë një faktorë shumë dallues në këtë aspekt. Përfundimisht mund të themi se takimet e tilla ballë për ballë si vazhdimësi e kontakteve përmes

internetit duket të jenë mjaft popullore në vendin tonë (se paku në mesin e fëmijëve të anketuar), 12% nga të cilët kanë deklaruar se kanë takuar mbi 10 persona në këtë mënyrë, dhe rreth 35% e tyre kanë deklaruar se kanë takuar 1 deri 2 persona në këtë mënyrë.

Siç kemi thënë edhe më lartë gjatë këtij hulumtimi se takimi me persona që së pari i kanë kontaktuar përmes internetit për fëmijët mund të jetë edhe argëtuese, mirëpo neve na brengosë fakti se këto takime mund të shpijnë deri tek përvoja të dëmshme për fëmijët dhe tek situata mjaft të rrezikshme për shëndetin fizik dhe psikologjik të fëmijëve. Andaj me pyetjen në vijim jemi munduar të gjejmë se sa janë shqetësuar fëmijët nga takimet e tilla.

Për të marrë përgjigje sa më të saktë dhe për të mos i gjykuar veprimet e tyre, në pyetjen në vijim ne kemi deklaruar se: “Takimi me dikë personalisht të cilin së pari e keni njoftuar përmes internetit mund të jetë në rregull ose jo në rregull...” duke e pasuar këtë me pyetjen:

*“Në 12 MUAJT e fundit a keni takuar dikën në këtë mënyrë i cili ju ka shqetësuar (penguar, nervozuar, mërzitur, lënduar) juve?”*

Rezultatet nga kjo pyetje janë treguar në tabelën e mëposhtme:

**Tabela 21. Në 12 MUAJT e fundit a keni takuar dikë në këtë mënyrë i cili ju ka shqetësuar (penguar, nervozuar, mërzitur, lënduar) juve?**

Kategoria	Po	Jo	Nuk e di	Preferoj të mos tregoj	Gjithsejt
Mashkull	30.0	62.1	3.3	4.5	100
Femër	23.2	71.2	4.0	1.7	100
9-12 vjeçar	33.0	59.4	3.6	4.0	100
13-16 vjeçar	20.4	73.5	3.6	2.6	100
Gjithsejt	27.1	66.0	3.6	3.3	100

Nga rezultatet e treguara më sipër shihet se fëmijët me moshë prej 9 deri 12 vjeçare janë ata të cilët më së shumti janë shqetësuar nga takimet ballë për ballë me dikë pasi që i kanë kontaktuar ata së pari përmes internetit, ku çdo i treti nga këta fëmijë kanë deklaruar të jenë shqetësuar nga takime të tilla. Ndërsa sa i përket gjinisë, djemtë duket të jenë më të shqetësuar nga takimet e tilla (rreth 30% e tyre) sesa vajzat (rreth 23%). Megjithatë, shumica e fëmijëve (rreth 66%) nuk janë shqetësuar nga takimet ballë për ballë me personat të cilët së pari i kanë kontaktuar përmes internetit.

### Me kënd takohen fëmijët!

Për të ditur më shumë rreth takimeve ballë për ballë, të cilat i kanë shqetësuar fëmijët dhe karakteristikat e atyre personave me të cilët janë takuar fëmijët, në pyetësor i kemi vendur dy pyetje lidhur me moshën dhe gjininë e atyre personave me të cilët janë takuar fëmijët. Rezultatet nga këto

pyetje janë treguar më poshtë:

**Tabela 22. Dhe nëse jeni shqetësuar nga ndonjë takim i tillë, çfarë moshe ka pasur ky person? Jam takuar me:....**

Kategoria	Dikë përafërsisht të moshës time	Dikë më i ri se unë	Tinejxher më (më i ri se 20 vjeç)	Një të rritur (i moshës 20 vjeç ose më shumë)	Nuk e di	Gjithsejt
Mashkull	58.8	15.3	12.9	2.4	10.6	100
Femër	61.1	24.1	0.0	0.0	14.8	100
9-12 vjeçar	51.8	22.4	9.4	2.4	14.1	100
13-16 vjeçar	72.2	13.0	5.6	0.0	9.3	100
Gjithsejt	59.7	18.7	7.9	1.4	12.2	100

Shqetësimi nga takimi me fëmijë më të rinj sesa fëmijët e anketuar duket të jetë më popullor për vajzat (rreth 24%) dhe fëmijët e moshës 9 deri 12 vjeç (rreth 22%) krahasuar me djemtë (rreth 15%) dhe fëmijët e moshës 13 deri 16 vjeç.

Vajzat nuk duket të kenë pasur ndonjë takim që i ka shqetësuar me adoleshentë nën 20 vjeç apo me të rriturit mbi moshën 20 vjeçare. Kurse, 12% e djemve janë shqetësuar nga takimi me adoleshentë më të ri se 20 vjeç, dhe vetëm 2% kanë takuar ndonjë të rritur të moshës mbi 20 vjeç i cili takim i ka shqetësuar ata.

Nga tabela e treguar më lart shihet se shumica e fëmijëve (rreth 60%) janë shqetësuar nga takimi, ballë për ballë pasi ti kenë kontaktuar përmes internetit, me fëmijët e moshës së tyre.

Ndërsa rezultatet lidhur me gjininë e personave të cilët ata i kanë takuar ballë për ballë pasi janë njoftuar së pari përmes internetit, dhe takimet e tilla i kanë shqetësuar ata, janë treguar në tabelën 24, e paraqitur më poshtë:

**Tabela 23. Dhe, a ishte ai person femër apo mashkull?**

Kategoria	Mashkull	Femër	Gjithsejt
Mashkull	54.2	45.8	100
Femër	34.7	65.3	100
9-12 vjeçar	49.4	50.6	100
13-16 vjeçar	43.4	56.6	100
Gjithsejt	47.0	53.0	100

Nga tabela e treguar më lart shihet se fëmijët janë shqetësuar kryesisht nga takimet me persona të gjinisë së njëjtë me ta. Në përgjithësi shihet se shqetësimi nga takimet me persona të cilët së pari kanë kontaktuar përmes internetit është i njëjtë për të dy gjinitë (rreth 47% për gjininë mashkullore dhe 53% për gjininë femërore). Ndërsa sa i përket moshës, për fëmijët 9 deri 12 vjeç gjinia nuk duket të përbejë ndonjë dallim të madh, kurse fëmijët prej moshës 13 deri 16 vjeç duket të jenë shqetësuar më shumë nga takimet me personat e gjinisë femërore (rreth 57%) sesa ata të gjinisë mashkullore (rreth 43%).

## Faktorët tjerë të rrezikut

Deri tani, në kapitujt më lart kemi përshkruar deri diku rreziqet e përdorimit të internetit nga fëmijët, përfshirë: rreziku në internet, seksualiteti, sajberdhuna, takimi me njerëz të rinj. Këto rreziqe potenciale janë definuar si të tilla në hulumtime të ngjashme në shume vende të botes. Mirëpo, ne jemi të vetëdijshëm që përveç tyre ka dhe shumë rreziqe tjera potenciale të cilat ne nuk kemi mundur ti hulumtojmë, për shkak të limiteve buxhetore dhe metodologjike.

Sidoqoftë, në hulumtimin tonë kemi përfshirë edhe disa forma tjera të rrezikut të mundshëm për fëmijët gjatë përdorimit të internetit, për të cilat do të flasim në vijim. Këto rreziqe mund të jenë të natyrave të ndryshme dhe fëmijët shumë lehtë mund t'iu ekspozohen atyre.

## Publikimi i të dhënave personale në internet nga fëmijët

Përdorimi në shkallë të gjerë i rrjeteve sociale dhe formave tjera të komunikimit përmes internetit nga fëmijët në vendin tonë tregon se edhe ne jemi të ekspozuar ndaj rreziqeve që vijnë nga publikimi në këto faqe të internetit i të dhënave personale. Fëmijët mund të mos jenë të vetëdijshëm se informatat të cilat ata kanë vendosur në profilet e tyre apo në forma tjera në internet mund të jenë të dëmshme apo mund ti vendosin ata në situata të palakmueshme apo edhe të rrezikshme. Prandaj prindërit dhe kujdestarët janë ata që duhet udhëzuar fëmijët se cilat informata ata mund ti bëjnë publike. Duhet theksuar se publikimi i informata personale siç janë: adresa e shtëpisë, numri i telefoni, email-i, shkola në të cilën ata i vijnë mësimet, fotografitë e tyre mund të jenë mjaft të rrezikshme andaj rekomandohet që informatat e tilla të mos publikohen në internet nga fëmijët.

Për të parë se sa është e shprehur dukuria e publikimit të të dhënave personale e fëmijëve tek ne, në pyetësorin tonë ne kemi vendosur pyetjen siç vijon:

“Cilat nga këto informata i publikoni (vendosni) në profilin tuaj?

Fotografi

Emrin e shkollës suaj

Adresën e shtëpisë suaj

Numrin e telefonit

E-mail adresën tuaj”

Ndërsa fëmijët kanë mundur të zgjedhin opsionet 'Po', 'Jo' ose 'Nuk e di'. Ndërsa nga anketuesi është shpjeguar në detaje se çfarë kemi nënkuptuar me fjalën profil në pyetjen e përmendur më lart. Rezultatet nga kjo pyetje janë treguar në tabelën e më poshtme.

**Tabela 24. Cilat nga këto informata i publikoni (vendosni) në profilin tuaj?**

Kategoria	P o	J o	Nuk e di	G jithsejt
Fotografi	88.5	10.5	1.0	100
Emrin e shkollës suaj	71.3	26.6	2.1	100
Adresën e shtëpisë suaj	9.6	88.1	2.4	100
Numrin e telefonit	7.9	90.3	1.8	100
E-mail adresën	50.5	47.4	2.2	100

Nga tabela e treguar më sipër shihet shumica e fëmijëve vendosin foton dhe emrin e tyre në profilin e tyre në internet (në rrjetet sociale apo forma tjera të prezantimit në internet). Publikimi i adresës së shtëpisë dhe numrit të telefonit është më i pak i shprehur, me rreth 10% respektivisht 8% e fëmijëve. Ndërsa pothuajse çdo i dyti fëmijë publikon e-mail adresën e tij/saj në internet.

Djemtë kanë tendencë më të madhe (rreth 55% e tyre) për të publikuar fotot e tyre në internet krahasuar me vajzat (rreth 45% e tyre). Kurse sa i përket moshës, fëmijët nga mosha 9-12 vjet kanë më shumë tendencë (rreth 62%) për të publikuar fotografite e tyre në internet, sesa ata të moshës më të rritur (rreth 38%). Publikimin e emrit të shkollës e bëjnë pothuajse njësoj të dy gjinitë. Ndërsa fëmijët e moshës më të vogël, rreth 58% e tyre, publikojnë emrin e shkollës që ata vijoje, krahasuar me ata të moshës më të rritur, nga mosha 13 deri 16 vjeç ku 42% e tyre publikojnë emrin e shkollës ku ata vijoje në mësimet.

Nga rreth 10% të fëmijëve që kanë deklaruar se në profilin e tyre në internet publikojnë adresën e shtëpisë së tyre, 65% janë djem dhe 35% vajza. Ndërsa rreth 70% prej tyre janë të moshës nga 9 deri 12 ndërsa 30% e tyre janë nga mosha 13 deri 16 vjeç.

Nga rreth 8% të fëmijëve që kanë thënë se publikojnë numrin e tyre të telefonit, 84% e tyre janë fëmijë të gjinisë mashkullore ndërsa 16% janë femra. Kurse 63% e tyre janë të moshës nga 9 deri 12 vjeçare ndërsa 37% e tyre janë nga mosha 13 – 16 vjeç.

Nga çdo të dytit fëmijë që kanë deklaruar se publikojnë e-mailin e tyre në internet, 63% e tyre janë meshkuj kurse 37% janë fëmijë të gjinisë femërore. Kurse 58% e tyre janë fëmijë të moshës nga 9 deri 12 vjeç dhe 42% fëmijë të moshës nga 13 deri 16 vjeç.

## Keqpërdorimi i të dhënave personale

Një ndër çështjet më të rëndësishme për sigurinë e fëmijëve në internet është edhe çështja se kush ka qasje në të dhënat e tyre personale që gjenden në internet, me ose pa vetëdijen e përdoruesve të internetit. Për të pasur më të lehtë për të kuptuar fëmijët pyetjen lidhur me keqpërdorim të të dhënave personale në internet ne kemi pyetur fëmijët siç vijon:



*“Në 12 muajt e fundit, a ju ka ndodhur ndonjëra nga këto gjëra në internet?*

*Kompjuteri juaj është sulmuar nga ndonjë virus*

*Dikush ka keqpërdorur të dhënat tuaja personale*

*Ju ka vjedhur dikush e-mailin (password’in)”*

Ndërsa ata kanë pasur mundësi të zgjedhin në mes te opsioneve: ‘Po’, ‘Jo’ ose ‘Nuk e di’. Sigurisht, anketuesi ua ka shpjeguar se çfarë kemi nënkuptuar me të dhënat personale të fëmijëve. Rezultatet nga kjo pyetje janë treguar në tabelën e më poshtme.

**Tabela 25. Në 12 muajt e fundit, a ju ka ndodhur ndonjëra nga këto gjëra në internet?**

Kategoria	Po	Jo	Nuk e di	Gjithsejt
Kompjuteri juaj është sulmuar nga ndonjë virus	49.4	43.3	7.3	100
Dikush ka keqpërdorur të dhënat tuaja personale	16.3	79.9	3.8	100
Ju ka vjedhur dikush e-mailin (password’in)”	27.5	70.2	2.3	100

Nga rezultatet e treguara në tabelën më sipër shihet se pothuajse gjysma e fëmijëve kanë deklaruar se kompjuterët e tyre janë sulmuar nga ndonjë virus. Ndërsa 16 % e fëmijëve kanë deklaruar se të dhënat e tyre personale janë keqpërdorur në internet. Po ashtu rreth 28% e fëmijëve kanë deklaruar se dikush ua ka vjedhur fjalëkalimin e e-mailit të tyre personal.

Nga rreth 49% e atyre fëmijëve që kanë deklaruar se kompjuteri i tyre është sulmuar nga ndonjë virus, 53% prej tyre janë meshkuj ndërsa 47% prej tyre janë fëmijë të gjinisë femërore. Ndërsa 57% janë fëmijë nga mosha 9 deri 12 vjeç dhe 43% janë fëmijë nga mosha 13 deri 16 vjeç.

Prej 16% të fëmijëve që kanë deklaruar se dikush ka keqpërdorë të dhënat e tyre personale, 53% e tyre janë fëmijë të gjinisë mashkullore, ndërsa 47% janë të gjinisë femërore. Ndërsa 72% e tyre janë fëmijë nga mosha 9 deri 12 vjeç dhe 28% e tyre janë të moshës nga 13 deri 16 vjeç.

Ndërsa nga rreth 28% e fëmijëve të cilëve u është vjedhur fjalëkalimi i e-mailit të tyre personal, gjysma e tyre kanë qenë të gjinisë mashkullore dhe kuptohet gjysma tjetër të gjinisë femërore. Ndërsa 66% e tyre kanë qenë fëmijë të moshës nga 9 deri 12 vjeç dhe 28% fëmijë nga mosha 13 deri 16 vjeç.

## Ngritja e vetëdijes përmes këtij projekti

Në muajin nëntor 2012 është mbajtur edhe një anketë me fëmijët e Prishtinës me qëllim që të matet efektiviteti nga seminarët dhe aktivitetet e tjera të Qendrës FIT për ngritjen e njohurive lidhur me sigurinë e fëmijëve në internet. Kjo anketë është mbajtur në katër shkolla fillore të Prishtinës. Në dy nga këto shkolla janë mbajtur seminarët dhe shpërndarë materiale edukative (Mileniumi i Tretë dhe Pjetër Bogdani) nga Qendra FIT kurse në dy shkolla të tjera nuk janë mbajtur seminare edukuese (Dardania dhe Naim Frashëri). Përmes pyetësorit të krijuar nga Qendra FIT janë anketuar gjithsej 595 fëmijë nga të katër shkollat.

Rezultatet e nxjerra nga deklaratimet (përgjigjet në pyetësor) të fëmijëve tregojnë se në shkollat që është punuar për të ngritur njohuritë është arritur efekt i kënaqshëm kurse në shkollat e tjera ka mungesë të theksuar të njohurive elementare për qasjen online dhe sigurinë në internet.

Rezultatet nga anketa e dytë të treguara në tabelat dhe grafikët në vijim paraqesin krahasimin e përgjigjeve të fëmijëve me të cilët është mbajtur kampanja edukuese dhe ata që nuk kanë qenë pjesë e kampanjës edukuese. Në pyetjen:

**“Informacionet në internet janë gjithmonë të vërteta. Ato nuk do të ishin në internet nëse nuk janë të sakta”** e cila ka poseduar opsionet: **e sakte ose e jo e saktë**.

53 % e fëmijëve të cilët kanë marr pjesë në seminare janë përngjitur me “jo e saktë” ndërsa 37% e atyre fëmijëve që nuk kanë marr pjesë në seminare edukuese janë përgjigjur me: jo e saktë”.

Në pyetjen:

**“Cilat nga këto informata mund të paraqesin rrezik për ju nëse i publikoni në internet: Foton tuaj, Adresën, Emrin e shkollës, numrin e telefonit, nofkën, emailin”.** e cila ka poseduar opsionet: **PO dhe JO**.

55% e fëmijëve që kanë marr pjesë në seminar janë përgjigjur me PO (do të thotë te postosh fotografinë personale në internet mund të paraqes rrezik për fëmijët) ndërsa 45% e fëmijëve që nuk kanë marr pjesë në seminar janë përgjigjur me PO.

Përderisa vetëm 30% e fëmijëve që kanë marr pjesë në seminare edukuese kanë deklaruar se publikimi i numrit të telefonit mobil **NUK** mund të paraqesë rrezik nëse publikohet në internet, 70% e atyre që nuk kanë marr pjesë në seminare kanë deklaruar të njëjtën.

Në pyetjen:

**“A bënë të përdorni kamerën gjatë bisedës me të panjohur?”.** Opsionet për përgjigje: **PO, JO**

dhe NUK E DI.

Vetëm 32% e fëmijëve që kanë marr pjesë në seminare edukative kanë deklaruar PO ndërsa 68% e atyre që nuk kanë marr pjesë në seminare kanë deklaruar PO (d.m.th. përdorin kamerën gjatë bisedës me të panjohur).

Në pyetjen:

“A duhet të pranoni kërkesa për shoqërim nga njerëzit që nuk i njihni personalisht?”.  
Opsionet për përgjigje: PO sepse kështu bëjë më shumë shokë në internet dhe JO sepse jo të gjithë në internet janë ata që thonë se janë.

Përderisa vetëm 40% e fëmijëve që kanë marrë pjesë në seminar janë përgjigjur me PO, 60% e atyre që nuk kanë marr pjesë në seminare janë përgjigjur me PO.

Në pyetjen:

A e përdorni ju personalisht internetin? Opsionet për përgjigje: PO dhe JO .

Rezultatet nga anketa (pyetësi i dytë) tregojnë se 98.9% e fëmijëve të anketuar në shkollat fillore në Prishtinë e përdorin internetin që krahasuar me anketën e parë është për 8.99% më e lartë.

Në pyetjen:

Informatat në internet janë gjithmonë të vërteta. Ato nuk do të ishin në internet po të mos ishin të vërteta. Opsionet për përgjigje: E saktë, Jo e saktë dhe Nuk e di.


Rezultatet tregojnë se 35.64% e fëmijëve të anketuar nga shkollat ku nuk është ofruar kampanja për sigurinë në internet nga Qendra FIT mendojnë se çdo informatë e që postohet në internet është plotësisht e vërtetë krahasuar me 19.11% e fëmijëve nga shkollat ku është mbajtur kampanja vetëdijësuese që kanë të njëjtin mendim.

Në pyetjen:

Cilat nga këto informata personale mund të paraqesin rrezik potencial për ju nëse i publikoni në internet?

Në këtë pyetje fëmijët kanë mundur të zgjedhin opsionet: Fotografia, Adresa, Telefoni, Emri i shkollës, Nofka ose pseudonimi, E-mail adresa dhe Nuk e di.

Figura 8. Përgjigjet në pyetjen e mësipërme të paraqitura në mënyrë grafike



Në grafikun e treguar më lartë janë dhënë vetëm rezultatet e përgjigjeve pozitive “PO” për informatat personale të cilat paraqesin rrezik nëse publikohen në internet nga fëmijët. Në grafiku shihet se përqindja e fëmijëve të cilët mendojnë se publikimi i fotografisë mund të paraqesin rrezik për fëmijët është me e lartë për fëmijët që kanë marr pjesë në kampanjën e FIT (76.85%) krahasuar me ata që nuk kanë marr pjesë në kampanjë (50.33%). Po ashtu fëmijët që kanë qenë pjesë e kampanjës së FIT duket të kenë njohuri më të mirë për rreziqet që iu paraqiten fëmijëve në krahasim me fëmijët që nuk kanë marr pjesë në kampanjë.

Në pyetjen:

Si duhet të veproni nëse dikush ju ngacmon, mërzitë ose shqetëson përmes internetit?  
Opsionet për përgjigje: T’ ia kthesh në mënyrë të njëjtë, Ta takosh dhe të qërosh hesapet me atë, Të njoftosh prindërit ose mësuesin, Ta injorosh dhe të mos i tregosh askujt dhe Nuk e di.

Përafërsisht 60% e fëmijëve që kanë ndjekur kampanjën vetëdijësuese mendojnë se duhet të njoftojnë prindërit ose mësuesin nëse i ngacmon ata dikush përmes internetit krahasuar me 46.6% të fëmijëve që nuk kanë marr pjesë në kampanjë.

Në pyetjen:

Nëse dikush ju ngacmon përmes internetit, biseda duhet të ruhet si dëshmi! E saktë apo e

**pasaktë?** Opsionet për përgjigje: **Biseda duhet të fshihet sepse mund të përmbajë viruse, Biseda duhet të ruhet si dëshmi dhe Nuk e di.**

70% e fëmijëve që kanë marr pjesë në kampanje e FIT mendojnë se bisedat në rast ngacmimi duhet të ruhen si dëshmi krahasuar me 57% të fëmijëve që nuk kanë marr pjesë në kampanjë.


Përdorimi i nofkës apo pseudonimit gjatë komunikimit në “chat” apo gjatë lojërave online konsiderohet i pranueshëm për 72.5% të fëmijëve që kanë marr pjesë në kampanjë edukuese krahasuar me 55.48% të fëmijëve që nuk kanë marr pjesë në kampanjë.

Përdorimi i Facebook-ut në mas të madhe nga fëmijët dhe njohuritë jo të mjaftueshme për përdorim të sigurt janë shkaqe për shqetësim. Gjatë kampanjës sonë edukuese jemi munduar që fëmijëve të ju japim informata të shumta për përdorimin e sigurt të Facebook-ut. Rezultatet e kampanjës janë vërejtur dukshëm edhe në përgjigjet e fëmijëve në pyetjen P.14. **A mundet ndokush të keqpërdor informacionet që ju personi në faqen tuaj të Facebook-ut?** Nga figurën e treguar më poshtë ku shihet se 79.8% të fëmijëve të cilët kanë marr pjesë në kampanjën e FIT mendojnë se informacionet e postuara në Facebook mund të keqpërdoren, ndërsa 74.2% e fëmijëve të cilët nuk kanë marr pjesë në kampanjë edukuese mendojnë se informacionet që ata postojnë në Facebook mund të keqpërdoren.

Po ashtu në pyetjes P.15. **Tregimi i vendndodhjes suaj përmes shërbimit të Facebook-ut (check-in) se ku gjendeni mund të jetë e rrezikshme!** Opsionet për përgjigje në këtë pyetje: **E saktë ose jo e saktë.**

Po ashtu siç është treguar në figurën e treguar më poshtë 75.7% të fëmijëve të cilët kanë marr pjesë në kampanjën e FIT mendojnë se informacionet tregimi i vendndodhjes përmes Facebook-ut mund të jetë i rrezikshëm, ndërsa 61.3% e fëmijëve të cilët nuk kanë marr pjesë në kampanjë edukuese mendojnë se informacionet tregimi i vendndodhjes përmes Facebook-ut mund të jetë i rrezikshëm.

**Figura 9. Keqpërdorimi i informatave të postuara në Facebook dhe Check-in në Facebook.**



Një rrezik tjetër me të cilin fëmijët përballen online është edhe sajberdhuna apo dhuna (ngacmimi, kërcënimi, shqetësimi apo fyerja) që ushtrojnë fëmijët ndaj moshatareve të tyre përmes internetit. Se sa i nevojshëm është informimi i fëmijëve në këtë aspekt tregon edhe rezultati nga përgjigjet e fëmijëve në pyetjen për sajberdhunën ku 38.73% e fëmijëve që nuk kanë marr pjesë në kampanjë nuk kuptojnë termin sajberdhunë krahasuar me 9.93% të fëmijëve që kanë marr pjesë në kampanje edukuese.

Në përgjithësi rezultatet tregojnë se fëmijët të cilët nuk kanë marr pjesë në seminarin edukues për sigurinë në internet janë më pak të vetëdijshëm për rreziqet që mund të ju kanosen fëmijëve nga sjellja e tyre në internet. Pra fëmijët që kanë marr pjesë në seminar kanë përfituar njohuri për rreziqet në internet dhe dinë më mirë për t'iu shmangen rreziqeve në internet, krahasuar me ata që nuk kanë marr pjesë në këto seminare.

Po ashtu duhet potencuar se nga shkollat ku kemi mbajtur kampanjën edukuese rreth 85.26% e fëmijëve kanë deklaruar se kanë marr pjesë në kampanjën edukuese. Pra në mesin e të anketuarve ka pasur edhe nxënës që nuk kanë marr pjesë në kampanjë edukuese. Prandaj mund të themi se në rezultatet dhe krahasimet tona në mes të opinioneve të nxënësve nga shkollat ku është mbajtur kampanja edukuese me ato shkolla ku nuk është mbajtur kampanja dallimet do të kishin qenë shumë më të mëdha nëse të gjithë nxënësit e anketuar do të kishin qenë prezent në kampanjën e mbajtur nga Qendra FIT për sigurinë e fëmijëve në internet.

## Konkluzione dhe rekomandime

Në bazë të rezultateve të dalta nga pyetësi ynë për përdorimin e sigurt të internetit nga fëmijët kemi ardhur në përfundim se tek një pjesë e prindërve ka një mungesë e ngjergjegjësimit (vetëdijes) lidhur me rrezikun që fëmijët e hasin gjatë qëndrimit online. Prandaj, ne rekomandojmë që ndërgjegjësimi i prindërve lidhur me rrezikun dhe sigurinë në internet duhet të rritet. Kjo mund të bëhet duke filluar me rritjen e njohurive për llojet e rreziqeve që fëmijët e tyre mund të hasin gjatë qëndrimit online. Fëmijët janë deklaruar se internetin më së shumti e përdorin në shtëpi, kështu që prindërit e fëmijëve duhet të luajnë një rol kyç për të ndihmuar fëmijët kur ata hasin në ndonjë rrezik potencial. Prindërit duhet të ndërmarrin iniciativa për të ofruar këshilla lidhur me teknologjinë e fundit, llojet e rreziqeve dhe sigurinë në internet.

Në ditët e sotme fëmijët fillojnë të kyçen në moshë të re në internet. Nga rezultatet e këtij hulumtimi ka dale që vetëm 13% e fëmijëve të moshës 9 vjeç NUK kanë qasje në internet. Fëmijët e moshave të reja kanë mungesë të njohurive bazike në internet, kanë nevojë për rritje të aftësive digjitale, për edukim lidhur me shfrytëzimin e sigurt të internetit. Ne rekomandojmë që në shkollat fillore veçanërisht, të filloj edukimi i fëmijët nga mësuesit lidhur me sigurinë në internet.

Qasja në internet nga të ashtuquajturat 'internet caffè' në Kosovë është e lartë (15%) krahasuar me vendet e BE-së (12%). Zakonisht në këto ambiente nuk ka mbikëqyrje, monitorim apo filtrim të materialeve të cilat janë të pa përshtatshme për fëmijët. Ne sugjerojmë të bëhet më shumë hulumtim lidhur me aktivitete e fëmijëve në këto ambiente dhe që pronarët e këtyre lokaleve të marrin më shumë përgjegjësi për aktivitetet e fëmijëve në këto lokacione.

Në nivel kombëtarë, qeveria dhe rregullatorët do të duhet të inkurajonin zhvillimin e përmbajtjeve pozitive përmes financimit të prodhimit të programeve zhvillimore dhe edukative. Politikëbërësit duhet të sponzorojnë më shumë hulumtime rreth përdorimit të internetit, sigurisë online dhe rreziqet që lidhen me përdorimin e internetit. Industria duhet të ofroj më shumë mbështetje programeve dhe aktiviteteve për sigurinë në internet dhe për të mbrojtur fëmijët në internet, duke ofruar mundësi filtrimi, bllokimi, raportimi, përmes të të ashtuquajturve 'Parental Control' dhe 'Technical tools'. Qeveria do të duhej të siguroj trajnime për mësuesit dhe t'ju ofroj atyre material (literature) për të ndihmuar fëmijët të ngrisin kapacitete për vetëmbrojtje nga rreziqet në internet dhe të ngritin një 'Qendër për Ndërgjegjësim' e cila do të përgatiste dhe shpërndante material me informacione për prindërit. Materiale të ngjashme si për shembull, informacione se çka është 'Parental Control', cila është teknologjia dhe shërbimet që përdoren për momentin, do të duhet të shpërndahen nga kjo qendër në një format të thjeshtë dhe të kuptueshëm për të gjithë.

Më shumë ndihmë duhet tu ofrohet fëmijëve dhe prindërve lidhur me njohurit e duhura për të bërë bllokimin e përmbajtjeve të padëshiruara që shfaqen aksidentalisht, për shembull, fotografit, filmat apo videot me përmbajtje erotike. Prindërit duhet të diskutojnë me fëmijët e tyre për faqet e

internetit që janë të sigurta për tu vizituar dhe të dhënat personale që fëmijët postojnë në faqet e ndryshme të internetit. Prindërit duhet ti bindin fëmijët e tyre se monitorimi nga prindërit apo kujdestarët është në dobi të tyre dhe se në rast se fëmijët hasin në diçka që i shqetëson ata në internet ti lajmërojnë menjëherë kujdestaret apo prindërit e tyre.

Takimi personalisht me njerëz të cilët për herë të parë i kanë takuar/njohur përmes internet, gjithashtu është një çështje për shqetësim. Në hulumtimin tonë për sigurinë në internet ka dale që, 58% e fëmijëve janë takuar me persona që për herë të pari i kanë njohur përmes internetit, dhe se 27% e fëmijëve që kanë takuar dikë në këtë mënyrë në 12 muajt e fundit, kanë qenë të shqetësuar (penguar, nervozuar, mërztur, lënduar) nga ata. Kjo përqindje është dukshëm më e lartë për grup-moshën 9-12 vjeç, (rreth 33%), kundrejt grup-moshës 13-16 vjeç (20%). Kjo tregon se takimi ballë-për-ballë (face-to-face) me njerëz bazuar në kontaktet në internet është bërë dukuri e shpeshtë të paktën në Prishtinë, dhe kjo paraqet një rrezik serioz për fëmijët. Fëmijët duhet të alarmohen lidhur me rreziqet e mundshme nga takimet e tilla. Më shumë përgjegjësi në këtë aspekt duhet të marrin prindërit dhe mësimdhënësit.

Në nivel kombëtarë e ndërkombëtarë, një rol të rëndësishëm duhet ta luajnë edhe kompanitë që ofrojnë shërbime në internet. Në Britani të Madhe për shembull, shumë kompani që ofrojnë shërbime të internetit - siç janë BT ([www.bt.com](http://www.bt.com)), TalkTalk ([www.talktalk.co.uk](http://www.talktalk.co.uk)), etj. – tani ofrojnë softuerë falas të gjithë klientët e tyre për ti ndihmuar ata që të menaxhojnë aktivitetet online të fëmijëve të tyre. Gjithashtu ato ofrojnë edhe 'Parental Control' për t'i ndihmuar ata që të jenë më të sigurt kur hulumtojnë në internet. Ofruesit e shërbimeve në Kosovë gjithashtu duhet të garantojnë (sigurojnë) një siguri maksimale lidhur me privatësinë, posaçërisht për fëmijët dhe shërbimet që ata i përdorin zakonisht përmes rrjeteve sociale.

Si përfundim, në mesazhin tonë për sigurinë në internet të dalë nga ky hulumtim, mund të konkludojmë se përdorimi i internetit nga fëmijët dhe aktivitetet e tyre online duhet më shumë të fuqizohen se sa kufizohen. Me qasjen e fëmijëve online përmes telefonit mobil kufizimi është bërë gati i pamundur. Mirëpo, fokusi mund të përqendrohet në vetëdijesimi kundrejt përpjekjet për të nxitur ndjenjën e vetë-përgjegjësisë tek fëmijët.



## Çështje metodologjike

Është më se e kuptueshme se është e vështirë të matesh aspektet private dhe përvojat e këqija të fëmijëve. Andaj në përpjekjen tonë që ti qasemi sa më mirë matjes së rreziqeve të fëmijëve në internet ne kemi ndërmarr disa ndryshime metodologjike:

- Për të rritur sa më shumë që të jetë e mundur kualitetin e përgjigjeve të dhëna në pyetjet e anketës së realizuar nga FIT, çdo pyetje është lexuar fillimisht nga anketuesi mandej fëmijët kanë pasur mundësinë të pyesin (hapur me zë të lartë apo edhe individualisht) për çdo paqartësi për atë pyetje. Dhe kështu është vepruar me të gjitha pyetjet.
- Jemi munduar që të krijojmë një mjedis të qetë, anketat janë mbajtur në klasët e tyre të mësimin me kujdestarin e tyre prezent. U është bërë e qartë se emrat e nxënësve nuk do të përdoren, pra përgjigjet e tyre janë konfidenciale.
- Tek disa pyetje me përmbajtje më të komplikuar (pyetjes lidhur me përmbajtje të dëmshme në internet që ata kanë mundur të vijnë në kontakt; për shembull: video ose foto erotike) është dashur të shpjegohet në detaje kuptimi i tyre dhe t’iu ipet hapësira e nevojshme e kohës për tu sqaruar detajet e këtyre pyetjeve.
- Është zhvilluar një pilot anketë, me të cilën janë eliminuar disa pyetje më të ndërlikuara, dhe janë modifikuar forma e pyetjeve për të qenë më të thjeshta. Po ashtu janë shtuar më shumë udhëzime për tu kuptuar më mirë pyetjet dhe për të lehtësuar përgjigjen në ato pyetje.
- Jemi përpjekur që pyetjet të formulohen në atë mënyrë që t’iu shmangemi paragjytimeve për çështje e caktuara, duke dhënë nëse fëmijët janë shqetësuar nga përmbajtjet në internet, e jo duke kërkuar nga të deklarojnë ata nëse ato përmbajtje i kanë lënduar apo kanë qenë përvojë e hidhur për ta.

Për disa pyetje me përmbajtje të ndjeshme fëmijëve u është dhënë mundësia që të përgjigjen me ‘Nuk e di’ ose ‘Preferoj të mos tregoj’, sesa t’i detyrojmë që të dhënë përgjigje kur është e vështirë apo e sikletshme për fëmijët. Në përgjithësi një numër i vogël i përgjigjeve janë zgjedhur ato opsione mirëpo për shkaqe etike është e rëndësishme të u ipet ajo mundësi.

**Tabela A. Përgjigjet e fëmijëve në pyetjet e bërë në Pyetësin për matjen e rritjes së vetëdijes përmes kampanjës edukuese**

**Klasifikimi i variablave**

<b>P. 0a Shkolla</b>	<b>Frekuenca</b>	<b>% (p)</b>	<b>Bazë</b>	<b>Me kampanjë</b>	<b>Pa kampanjë</b>
Mileniumi i Tretë	118	19.83	595	19.83	-
Pjetër Bogdani	180	30.25	595	30.25	-
Dardania	167	28.07	595	-	28.07
Naim Frashëri	130	21.85	595	-	21.85
<b>P. 0b Klasa</b>					
Katër	92	15.46	595	14.09	16.84
Pesë	115	19.33	595	19.80	18.86
Gjashtë	96	16.13	595	14.77	17.51
Shtatë	98	16.47	595	16.44	16.50
Tetë	95	15.97	595	17.45	14.48
Nëntë	99	16.64	595	17.45	15.82
<b>P. 0c Shkollat me/pa kampanjë edukative</b>					
Mileniumi i Tretë & Pjetër Bogdani (me)	298	50.08	595	50.08	-
Naim Frashëri & Dardania (pa)	297	49.92	595	-	49.92
<b>P. 01 Moshë</b>					
8vjeç	7	1.18	595	1.01	1.35
9 vjeç	78	13.11	595	12.08	14.14
10 vjeç	111	18.66	595	17.11	20.20
11 vjeç	92	15.46	595	17.11	13.80
12 vjeç	111	18.66	595	18.46	18.86
13 vjeç	84	14.12	595	15.44	12.79
14 vjeç	88	14.79	595	13.76	15.82
15 vjeç	23	3.87	595	4.70	3.03
16 vjeç e më shumë	1	0.17	595	0.34	0.00
<b>P. 02 Gjinia</b>					
Djem	313	52.61	595	52.35	52.86
Vajza	282	47.39	595	47.65	47.14

<b>P. 03 A e përdorni ju personalisht internetin?</b>					
Po	598	98.99	595	98.99	-
Jo	6	1.01	595	-	1.01
<b>P. 04 Informacionet në internet gjithmonë janë të vërteta. Ato nuk do të ishin në internet nëse nuk janë të vërteta.</b>					
E saktë	159	27.32	595	19.11	35.64
Jo e saktë	259	44.5	595	52.9	35.99
Nuk e di	164	28.18	595	27.99	28.37
<b>P. 05. a. Cilat nga këto informata personale mund të paraqesin rrezik potencial për ju nëse i publikoni në internet: ...Fotografia e juaj?</b>					
Po	362	61.67	595	72.79	50.51
Jo	225	38.33	595	27.21	49.49
<b>P. 05. b. Cilat nga këto informata personale mund të paraqesin rrezik potencial për ju nëse i publikoni në internet: ...Adresën?</b>					
	455	77.51	595	81.63	73.38
	132	22.49	595	18.37	26.62
<b>P. 05. c. Cilat nga këto informata personale mund të paraqesin rrezik potencial për ju nëse i publikoni në internet: ...Numrin e telefonit mobil?</b>					
	417	71.04	587	79.59	62.46
	170	28.96	587	20.41	37.54
<b>P. 05. d. Cilat nga këto informata personale mund të paraqesin rrezik potencial për ju nëse i publikoni në internet: ...Emrin e shkollës?</b>					
Po	240	40.89	587	64.63	17.06
Jo	347	59.11	587	35.37	82.94
<b>P. 05. e. Cilat nga këto informata personale mund të paraqesin rrezik potencial për ju nëse i publikoni në internet: ...Nofkën ose Pseudonimin?</b>					
Po	107	18.23	587	22.79	13.65
Jo	480	81.77	587	77.21	86.35
<b>P. 05. f. Cilat nga këto informata personale mund të paraqesin rrezik potencial për ju nëse i publikoni në internet: ...E-mail adresën?</b>					
Po	324	55.2	587	65.65	44.71
Jo	263	44.8	587	34.35	55.29
<b>P. 05. g. Cilat nga këto informata personale mund të paraqesin rrezik potencial për ju nëse i publikoni në internet: ...Nuk e di?</b>					
Po	48	8.18	587	5.78	10.58
Jo	539	91.82	587	94.22	89.42

**P. 06 Si duhet të veproni nëse dikush ju ngacmon, mërzitë ose shqetëson gjatë komunikimit në internet?**

T' ia kthesh në mënyrë të njëjtë	55	9.34	589	8.14	10.54
Ta takosh dhe të qërosh hesapet me atë	50	8.49	589	5.08	11.9
Të njoftosh prindërit ose mësuesin	352	59.76	589	46.6	59.76
Ta injorosh dhe të mos i tregosh askujt	90	15.28	589	9.15	21.43
Nuk e di	42	7.13	589	9.52	7.13

**P. 07 Nëse dikush ju ngacmon online ...**

Biseda duhet të fshihet sepse mund të përmbajë viruse	149	25.65	758	21.23	30.10
Biseda duhet të ruhet si dëshmi	371	63.86	758	70.21	57.44
Nuk e di	61	10.50	758	8.56	12.46

**P. 08 A mendon se postimet e tua në internet mund të ndikojnë negativisht në reputacionin tuaj dhe të dëmtojnë suksesin tuaj në të ardhmen?**

Po	177	30.15	587	25.76	34.59
Jo	304	51.79	587	59.66	43.84
Nuk e di	106	18.06	587	14.58	21.58

**P. 09 Nuk ka asgjë të keqe nëse i dërgoj fotografi personale një personi të cilin e njoh vetëm nëpërmjet internetit?**

E saktë	137	23.3	588	117.75	28.81
Jo e saktë	415	70.58	588	77.47	63.73
Nuk e di	36	6.12	588	4.78	7.46

**P. 10 Kur luani lojëra online apo komunikoni në chat dhe forume, ju gjithmonë duhet të përdorni nofkën (pseudonimin) ...**

E saktë	376	64.05	587	72.54	55.48
Jo e saktë	112	19.08	587	15.93	22.26
Nuk e di	99	16.87	587	11.53	22.26

**P. 11 Kur ju plotësoni formularë online , për shembull kur hapni llogari online, ju duhet të:**

Plotësoni të gjitha fushat e zbrazëta	219	37.56	573	21.84	53.45
Plotësoni vetëm fushat e shënuar me*	167	28.64	573	41.3	15.86
Nuk e di	187	33.79	573	36.86	30.69

<b>P. 12 A keni nevojë të merrni pëlqimin e prindit për të instaluar ndonjë program (software) në kompjuterin tuaj?</b>					
Po	422	72.26	584	73.88	70.65
Jo	150	25.68	584	24.74	26.62
Nuk e di	12	2.05	584	1.37	2.73
<b>P. 13 Shkarkimi i muzikës dhe filmave pa pagesë është jo ligjor?</b>					
E saktë	314	53.58	586	60.88	
Jo e saktë	182	31.06	586	27.55	
Nuk e di	90	15.36	586	11.56	
<b>P. 14 A mundet ndokush të keqpërdorë informacionet që postoni ju në faqen e facebooku't?</b>					
Po	446	76.37	584	76.95	75.78
Jo	104	17.81	584	18.98	16.61
Nuk e di	34	5.82	584	4.07	7.61
<b>P. 14 Nëse vendosni të takoni ndonjë person të cilin e keni njohur vetëm përmes internetit, si duhet të veproni?</b>					
Në takim të merrni me vete një shok	172	29.60	581	24.91	34.38
Në takim të merrni me vete prindin	329	56.63	581	68.94	44.1
Të takoheni i vetëm me këtë person	80	13.77	581	6.14	21.52
<b>P. 15 Nëse pranoni ndonjë 'email me fajlla të bashkëngjitur' (attachments) nga ndonjë i panjohur, çfarë duhet të bëni?</b>					
Ta hapni dhe shikoni çfarë ka	125	21.66	577	12.41	31.01
Ta hapni dhe ta dërgoni edhe te shokët tuaj	25	4.33	577	4.83	3.83
Ta fshini menjëherë	341	59.1	577	69.66	48.43
Nuk e di	86	14.9	577	13.1	16.72
<b>P. 16. a. Cilat informata personale duhet ti publikoni në internet (profil)? Fotografinë?</b>					
Po	319	54.91	581	41.3	68.75
Jo	262	45.09	581	58.7	31.25
<b>P. 16. b. Cilat informata personale duhet ti publikoni në internet (profil)? Email adresën?</b>					
Po	98	16.87	581	16.04	17.71
Jo	483	83.13	581	83.96	82.29

<b>P. 16. c. Cilat informata personale duhet ti publikoni në internet (profil)? Adresën e shtëpisë?</b>					
Po	26	4.48	581	5.12	3.82
Jo	555	95.52	581	94.88	96.18
<b>P. 16. d. Cilat informata personale duhet ti publikoni në internet (profil)? Emrin e shkollës tuaj?</b>					
Po	163	28.06	581	18.77	37.5
Jo	418	71.94	581	81.23	62.5
<b>P. 16. e. Cilat informata personale duhet ti publikoni në internet (profil)? Moshën?</b>					
Po	187	32.24	580	25.6	39.02
Jo	393	67.76	580	74.4	60.98
<b>P. 16. f. Cilat informata personale duhet ti publikoni në internet (profil)? Numrin e telefonit?</b>					
Po	29	4.99	581	6.14	3.82
Jo	552	95.01	581	93.86	96.18
<b>P. 16. g. Cilat informata personale duhet ti publikoni në internet (profil)? Asnjërën nga këto?</b>					
Po	197	33.97	580	51.03	16.67
Jo	383	66.03	580	48.97	83.33
<b>P. 17 A bënë të përdorni kamerën gjatë bisedës me të panjohur?</b>					
Po	37	6.35	583	6.8	5.88
Jo	520	89.19	583	90.48	87.89
Nuk e di	26	4.46	583	2.72	6.23
<b>P. 18 A kanë të drejtë të tjerët të postojnë në internet informata tua personale (p.sh. foto ose video ku jeni të përfshirë edhe ju), pa pëlqimin tuaj?</b>					
Po	35	5.98	585	7.12	4.83
Jo	517	88.38	585	89.49	87.24
Nuk e di	33	5.64	585	3.39	7.93
<b>P. 19 Çfarë duhet të bëni nëse një person me të cilin ke biseduar një kohë të gjatë online, kërkon nga ti të shkëmbeni fjalëkalimet?</b>					
Mund ti shkëmbeni, sepse kjo do ta rrisë shoqërimin tuaj	44	7.61	579	5.78	9.51
Nuk duhet ti shkëmbeni në asnjë mënyrë fjalëkalimet	535	92.39	579	94.22	90.49

<b>P. 20 A duhet të pranoni kërkesa për shoqërim nga njerëzit që nuk i njihni personalisht?</b>					
Po, sepse kështu bëj më shumë shokë.	69	11.98	576	34	35
Jo, sepse, jo të gjithë në internet janë ata që thonë se janë.	507	88.02	576	258	249
<b>P. 21 Tregimi i vendndodhjes tuaj përmes shërbimit të facebook-ut (check-in), se ku gjendeni për momentin, është një sjellje e rrezikshme?</b>					
E saktë	385	66.61	578	72.26	60.84
Jo e saktë	103	17.82	578	15.41	20.28
Nuk e di	90	15.57	578	12.33	12.16
<b>P. 22 A duhet të jeni të sjellshëm në internet sikur në jetën e përditshme?</b>					
Po	523	90.33	579	87.07	93.68
Jo	56	9.67	579	12.93	6.32
<b>P. 23 Fotografitë dhe përmbajtjet që ju postoni mund të shihen nga prindërit, mësuesit ose miqtë tuaj.</b>					
E saktë	473	81.98	577	82.88	81.05
Jo e saktë	46	7.97	577	7.53	8.42
Nuk e di	58	10.05	577	9.59	10.53
<b>P. 24 A keni të drejtë që të tjerët në internet të ju respektojnë?</b>					
Po	518	89.46	579	89.42	89.51
Jo	24	4.15	579	3.75	4.55
Nuk e di	37	6.39	579	6.83	5.94
<b>P. 25 Cila nga këto veprime është sajberdhunë?</b>					
Dërgimi i e-mailave që mund të jenë kërcënues	411	71.35	576	87.67	54.58
Shkarkimi (download) i muzikës	26	4.51	576	2.4	6.69
Nuk e di	139	24.13	576	9.93	38.73
<b>P. 26 Çfarë duhet të bëni nëse keni ndonjë informatë lidhur me trafikim të fëmijëve?</b>					
Të lajmëroni policinë ose prindin	492	86.16	571	87.24	85.05
Të heshtni sepse rrezikoni vetveten	30	5.25	571	5.52	4.98
Nuk e di	49	8.58	571	7.24	9.96

**P. 27 A e keni marrë pjesë në seminarin e organizuar nga Qendra FIT?**

Po	243	44.02	552	84.97	-
Jo	309	55.98	552	14.69	100

**P. 28 Sa mendon se janë rritë njohuritë tuaja pas pjesëmarrjes në seminarin për sigurinë në internet?**

Janë rritë shumë	173	65.78	264	65.78	-
Deri diku	38	14.07	264	14.07	-
Jo aq shumë	19	7.22	264	7.22	-
Aspak	9	3.42	264	3.42	-
S'kam përgjigje	25	9.51	264	9.51	-



Këtë publikim mund ta gjeni edhe në  
formë elektronike në adresën:

[www.internetisigurte.org](http://www.internetisigurte.org)

Në qoftë se dëshironi të keni kopje të  
shkruara të tij mund t'i kërkonit në adresën:

Qendra për studime të avancuara FIT  
Lagjia "Ulpiana"  
Rruga: Eqrem Qabej, Lokali nr.166,  
10000, Prishtinë, Kosovë

ose duke dërguar një e-mail në adresën:

[info@internetisigurte.org](mailto:info@internetisigurte.org)

Tirazhi: 200 Kopje



## Kontakti

Qendra për studime të avancuara FIT  
Rruga: Eqrem Qabej, Lokali nr.166, Prishtinë 10000, Kosovë  
Tel.: +377 (0) 44 145 282  
info@fit-ks.org  
qendrafit@gmail.com

Ky projekt u financua përmes grantit të Ambasadës Amerikane në Prishtinë. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Autorëve dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Departamentit të Shtetit.



[www.internetisigurte.org](http://www.internetisigurte.org)